



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 8 tetor 2025
Nr. ref.: AGJ 2815/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO265/25

Parashtrues

Igor Simić dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
“Procesverbaleve të seancave të Kuvendit të Kosovës”, si dhe vendimeve të
nxjerra në kuadër të Seancës Konstituive më 26 dhe 28 gusht 2025**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi – Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Igor Simić, Slavko Simić, Verica Čeranić, Zlatan Elek, Adem Hodža, Srđan Popović, Branislav Nikolić, Stefan Kovačević, Miljana Nikolić dhe Ljiljana Stefanović, deputetë të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), të cilët i përfaqëson Igor Simić, deputet i zgjedhur i Kuvendit (në tekstin mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

Akti i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*Procesverbaleve të seancave të Kuvendit të Kosovës*” dhe vendimeve të nxjerra në seancat e 26 dhe 28 gushtit 2025 (në tekstin e mëtejme: aktet e kontestuar).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të kontestuar për të cilat parashtruesit e kërkesave pretendojnë se janë shkelur neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 24 [Barazia para Ligjit], paragrafi 4 i nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës, dhe neni 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe janë në kundërshtim me Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet KO119/14, KO124/25 dhe KO193/25 dhe KO196/25. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se është shkelur pika 1 e paragrafit 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit.
4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme, “*me të cilën do të ndalojë veprimet e mëtejshme kundërkushtetuese të Kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që të mos zgjidhet Qeveria kundërkushtetuese ose të fillojnë të rrjedhin afatet për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, për shkak se moskaktimi i masës së përkohshme do të shkaktonte dëme të pariparueshme dhe potencialisht do të çonte në formimin e institucioneve kundërkushtetuese, duke cenuar kështu rendin juridik dhe demokratik në Kosovë*”.

Baza juridike

5. Kërkesa është parashtruar bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve), 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës Nr.01/2023 së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 30 gusht 2025, parashtruesit e kërkesës përmes postës elektronike dorëzuan kërkesën në Gjykatë, të cilën kjo e fundit e regjistroi më 1 shtator 2025.
7. Më 1 shtator 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KO265/25] caktoi gjyqtarin Enver Peci Gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KO265/25] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
8. Më 3 shtator 2025, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës: (i) parashtruesit e kërkesës, të cilëve iu kërkoj specifikimin e vendimeve të kontestuar; (ii) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Presidentja), e cila u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së komenteve; (iii) Avokatin e Popullit, i cili u njoftua edhe për mundësinë e dhënies së

komenteve; (iv) Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit), të cilit iu kërkua që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet relevante në lidhje me objektin e çështjes së kontestuar dhe që një kopje të kërkesës t'ua dorëzojë të gjithë deputetëve të Kuvendit. Afati për dorëzimin e komenteve dhe dokumenteve relevante të Kuvendit, u caktua më së largu deri më 9 shtator 2025, ndërsa për parashtruesit e kërkesës, afati për plotësimin e saj u caktua deri më 5 shtator 2025.

9. Më 4 shtator 2025, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentacionin në vijim:

- (i) Propozimin e 9 (nëntë) deputetëve të Listës Serbe të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës, nr.09/049/Do-030, të 26 gushtit 2025;
- (ii) Propozimin e 7 (shtatë) deputetëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë të kandidatit për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës, nr.09/050/Do-031, të 26 gushtit 2025;
- (iii) Njoftimin e deputetit Nenad Rašić për nënkryetar të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, nr.09/051/Do-032, të 26 gushtit 2025;
- (iv) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Albulena Haxhiu, Kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-009, të 20 gushtit 2025;
- (v) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetës Donika Gërvalla-Schwarz, Kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-010, të 20 gushtit 2025;
- (vi) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetit Hekuran Murati, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-011, të 22 gushtit 2025;
- (vii) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetit Hekuran Murati, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-012, të 24 gushtit 2025;
- (viii) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetes Arbërie Nagavci, Kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-013, të 24 gushtit 2025;
- (ix) Vendimin e Kuvendit për moszgjedhjen e deputetit Dimal Basha, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-014, të 24 gushtit 2025;
- (x) Vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e deputetit Dimal Basha, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-015, të 26 gushtit 2025;
- (xi) Vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e 3 (tre) nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr.09-V-016, të 26 gushtit 2025;
- (xii) Vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e deputetes Emilija Redžepi, nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, nr.09-V-017, të 26 gushtit 2025;
- (xiii) Vendimet: nr.09-V-018, nr.09-V-019, nr.09-V-020, nr.09-V-021, nr.09-V-022, nr.09-V-023 dhe nr.09-V-024, nga vazhdimi i Seancës Konstituive të 26 gushtit 2025, për moszgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, nga radha e komunitetit Serb;
- (xiv) Vendimet: nr.09-V-025, nr.09-V-026, nr.09-V-027, nr.09-V-028, nr.09-V-029, nr.09-V-030, nr.09-V-031, nr.09-V-032, nr.09-V-033, nr.09-V-034, nr.09-V-035, nr.09-V-036 dhe nr.09-V-037, nga vazhdimi i Seancës Konstituive me 28 gusht 2025, për moszgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, nga radha e deputetëve të komunitetit Serb;
- (xv) Vendimet: nr.09-V-038, nr.09-V-039, nr.09-V-040, nr.09-V-041, nr.09-V-042 dhe nr.09-V-043, nga vazhdimi i Seancës Konstituive me 30 gusht 2025, për moszgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, nga radha e komunitetit Serb; dhe
- (xvi) Transkriptin e vazhdimit të Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (e filluar me 15 prill 2025) me: 20, 22, 24, 26, 28 dhe 30 gusht 2025.

10. Në të njëjtën ditë, Kolegji shqyrtues shqyrtoi propozimin e Gjyqtarit raportues përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme. Në po të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që (i) të caktojë *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtruesve masën e përkohshme përmes të cilës ndalohet çdo veprim i deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe çdo procedurë për formimin e Qeverisë (ii) të urdhërojë që masa e përkohshme hyn në fuqi më 5 shtator 2025, në kohëzgjatje deri më 30 shtator 2025; (iii) t'ua kumtojë këtë Vendim palëve; (iv) të publikojë këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe që (v) vendimi hyn në fuqi më 5 shtator 2025.
11. Më 9 shtator 2025. Presidentja, deputetja Saranda Bogujevci nga Lëvizja Vetëvendosje! (në tekstin e mëtejshëm: LVV!), “*Grupi Multietnik*” dhe Kryetari i zgjedhur i Kuvendit z. Dimal Basha dorëzuan komente lidhur me kërkesën KO265/25.
12. Më 24 shtator 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të propozuar nga Gjyqtari raportues dhe vendosi që shqyrtimin e kërkesës ta shtyjë për një seancë të radhës pas plotësimeve shtesë.
13. Më 30 shtator 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata në përbërje të plotë, pas këshillimit, njëzëri, vendosi: (i) të konstatojë, që Seanca Konstituive e Kuvendit, e filluar me 15 prill 2025 nuk ka përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, dhe Kuvendi nuk është konstituuar në pajtim me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafët 1 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (ii) të urdhërojë, që Seanca Konstituive e Kuvendit të përfundojë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, përkatësisht brenda afatit të mbetur prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi; (iii) të urdhërojë, të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që gjatë procedurës së zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, të ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit; (iv) të vazhdojë, masën e përkohshme, e cila ka hyrë në fuqi nga data 5 shtator 2025, deri në hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi; (v) t'ua kumtojë këtë Aktgjykim palëve; (vi) ta publikojë këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe (vii) të konstatojë që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe njoftimit të palëve, përveç pikës V të dispozitivit, e cila hyn në fuqi menjëherë.

Përmbledhja e fakteve

14. Gjykata fillimisht thekson që kërkesa e parashtruesve ndërlidhet me Seancën Konstitutive të Legjislaturës së IX-të të Kuvendit (në tekstin e mëtejshëm: Seanca Konstituive), e cila ishte objekt shqyrtimi edhe në dy kërkesat paraprake të dorëzuara para Gjykatës, respektivisht, kërkesën KO124/25, me parashtrues *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë tjerë të Kuvendit* dhe kërkesat e bashkuara nr. KO193/25 dhe KO196/25, me parashtrues:

KO193/25, *Memli Krasniqi dhe 12 (dymbëdhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit*; dhe KO196/25, *Hykmete Bajrami dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit*.

15. Në vijim, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e kërkesës konkrete, Gjykata do të reflektojë konstatimet e Gjykatës në rastet e lartcekura.

16. Më 26 qershor 2025, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KO124/25, konstatoi që:

(i) Seanca e konstituimit të Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, nuk ka përfunduar dhe si rezultat i moszgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës e njëjta nuk është zhvilluar në pajtim me përcaktimet dhe kërkesat e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës; dhe

(ii) Deputetët e zgjedhur të Kuvendit, në zbatim të paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] në ndërlidhje me nenin 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve], nenin 70 [Mandati i Deputetëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kreun IV të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Aktgjykimin duhet që sa më shpejtë dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë të përfundojnë seancën konstituive të Kuvendit duke zgjedhur Kryetarin dhe nënkryetarët e tij (shih dispozitivin e Aktgjykimit në rastin e Gjykatës, KO124/25, me parashtrues të kërkesës *Time Kadrijaj dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së “*Vendimit të Kuvendit të Kosovës për refuzim të formimit të Komisionit për votim të fshehtë, si dhe të gjitha vendimet tjera që kanë natyrë të njëjtë me te të marra në seancat paraprake dhe të mëpastajmë për të njëjtën çështje, i përmbajtur në dokumentin e titulluar "transkript i mbledhjes konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e mbajtur më 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29 prill, 1, 3 dhe 5 maj 2025"*).

17. Më 7 gusht 2025, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastet KO193/25 dhe KO196/25, konstatoi që:

(i) deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e 26 qershorit 2025, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO124/25, dhe rrjedhimisht të gjitha seancat e mbajtura nga data 27 qershor deri më 26 korrik 2025 shpallen të pavlefshme;

(ii) që Kryesuesi i Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KO124/25, të 26 qershorit 2025 dhe rrjedhimisht veprimet e tij janë në papajtueshmëri me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

si dhe urdhëroi:

(iii) Kryesuesin e Seancës Konstituive të Kuvendit të Republikës së Kosovës të vazhdojë me pikën 3 të rendit të ditës së Seancës Konstituive, të miratuar më 8 prill 2025, dhe në pajtim me paragrafin 2 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të ftojë përfaqësuesin e grupit më të madh parlamentar për të propozuar kandidatin/en për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i/e cili/cila zgjidhet përmes votimit të hapur, votim i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë;

(iv) të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë procedurës së

zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të jenë të pranishëm dhe të votojnë;

(v) deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që të zgjedhin Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas pikave 3 dhe 4 të rendit të ditës të Seancës Konstituive brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi;

18. Më 18 gusht 2025, Aktgjykimi i Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25 hyri në fuqi.
19. Më 20 gusht 2025, vazhdoi Seanca Konstitutive e Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, dhe e ndërprerë më 26 korrik 2025 si rezultat i caktimit të masës së përkohshme *ex-officio* nga Gjykata. Të pranishëm në seancë ishin 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) deputetë. Kryesuesi i Seancës Konstituive pasi që përsëriti të gjeturat e Aktgjykimit të Gjykatës, kërkoi nga përfaqësuesi i LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputeten Albulena Haxhiu. Propozimi i LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kundër, dhe 3 (tre) abstenime.
20. Në të njëjtën ditë, Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesja e LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputeten Donika Gërvalla-Schwarz. Propozimi i LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kundër, dhe 3 (tre) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre.
21. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-009] dhe [nr. 09-V-010] nuk zgjodhi deputetet Albulena Haxhiu dhe Donika Gërvalla-Schwarz Kryetare të Kuvendit.
22. Më 22 gusht 2025, vazhdoi Seanca Konstitutive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) deputetë. Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesja e LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputetin Hekuran Murati. Propozimi i LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për, 52 (pesëdhjetë e dy) kundër, dhe 6 (gjashtë) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre.
23. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-011] nuk zgjodhi deputetin Hekuran Murati Kryetar të Kuvendit.
24. Më 24 gusht 2025, vazhdoi Seanca Konstitutive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 106 (njëqind e gjashtë) deputetë. Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesja e LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputetin Hekuran Murati. Propozimi i Lëvizjes LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 55 (pesëdhjetë e pesë) vota për, 46 (dyzet e gjashtë) kundër, dhe 5 (pesë) abstenime.
25. Në të njëjtën ditë, Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesi i LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky e fundit propozoi deputeten Arbërie Nagavci. Propozimi i LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 55 (pesëdhjetë e pesë) vota për, 47 (dyzet e shtatë) kundër, dhe 4 (katër) abstenime.

26. Në të njëjtën ditë, Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesja e LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për kryetare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputetin Dimal Basha. Propozimi i LVV! nuk kaloi për shkak se i mori 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota për, 25 (njëzet e pesë) kundër, dhe 24 (njëzetekatër) abstenime. Pas votimit seanca u ndërpre.
27. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-012], [nr. 09-V-013] dhe [nr. 09-V-014] nuk zgjodhi deputetët Hekuran Murati, Arbërie Nagavci dhe Dimal Basha Kryetar të Kuvendit.
28. Më 26 gusht 2025, vazhdoi Seanca Konstitutive e Kuvendit, ku të pranishëm ishin 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) deputetë. Kryesuesi i Seancës Konstituive kërkoi nga përfaqësuesja e LVV!, që të propozojë kandidatin apo kandidaten për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku kjo e fundit propozoi deputetin Dimal Basha. Propozimi i LVV! kaloi për shkak se i mori 73 (shtatëdhjetë e tri) vota për, 30 (tridhjetë) kundër, dhe 3 (tri) abstenime.
29. Si rrjedhojë, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-015] zgjodhi deputetin Dimal Basha, Kryetar të Kuvendit. I njëjti mori drejtimin e Seancës Konstituive, të cilën e ndërpreu për një pauzë njëorëshe.
30. Në të njëjtën ditë, pas pauzës, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit e vazhdoi Seancën Konstituive përkitazi me pikën e IV-të të rendit të ditës, respektivisht, zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Të pranishëm në seancë ishin 110 (njëqind e dhjetë) deputetë. Kryetari i zgjedhur i Kuvendit pasi që iu referua paragrafit 3 të nenit 67 të Kushtetutës dhe paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, dhe pasi konstatoi se: *“Kemi konsensus te përfaqësuesit e tri subjekteve më të mëdha të grupeve parlamentare që të vazhdojmë me votimin në pako”*, kërkoi nga përfaqësuesit e grupeve më të mëdha parlamentare që përfaqësojnë komunitetin shumicë, gjegjësisht, LVV!, Partinë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PDK) dhe Lëvizjen Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: LDK), që të propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku këta të fundit propozuan deputetët: Albulena Haxhiu, Vlora Çitaku dhe Kujtim Shala. Propozimet për nënkryetarë të Kuvendit që përfaqësojnë komunitetin shumicë kaluan duke u votuar në pako, për shkak se morën 101 (njëqind e një) vota për, asnjë kundër dhe 9 (nëntë) abstenime.
31. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-016] zgjodhi deputetët Albulena Haxhiu, Vlora Çitaku dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të zgjedhur të Kuvendit.
32. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit e vazhdoi Seancën Konstituive përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit që përfaqësojnë deputetët e komuniteteve që nuk janë shumicë. Pasi që iu referua paragrafit 4 të nenit 67 të Kushtetutës dhe paragrafit 4 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ndërmori veprimet si në vijim:
 - (i) ftoi përfaqësuesin e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, që të propozojë nënkryetarin/en e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky i fundit propozoi me rotacion deputeten Emilia Redžepi nga 26 gushti 2025 deri më 26 dhjetor 2026, deputeten Fidan Jilta nga 26 dhjetori 2026 deri më 26 qershor 2027,

si dhe deputetin Artan Asllani nga 26 qershor 2027 deri në përfundim të mandatit, si dhe kërkoi që votimi për nënkryetarin nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, të bëhet ndarazi nga nënkryetari tjetër nga komuniteti Serb;

- (ii) ftoi përfaqësuesin e deputetëve të komunitetit Serb, që të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky i fundit propozoi deputetin Slavko Simić;
- (iii) konstatoi se nuk ka *“konsensus nëse të vazhdohet me votimin në pako të komuniteteve joshumicë”* si dhe ia dha fjalën deputetit Nenad Rašić pas kërkesës së këtij të fundit, i cili nominoi veten për kandidat për nënkryetar që përfaqëson deputetët e komunitetit Serb;
- (iv) konstatoi përfundimisht se: *“ka papajtueshmëri që të vazhdohet me votimit në pako, rrjedhimisht si kryetar i Kuvendit propozoj që votimi për komunitetet joshumicë të bëhet veç e veç”*, dhe më pas kërkoi nga 110 (njëqind e dhjetë) deputetët e pranishëm, që të votojnë kandidatin e propozuar nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë, i cili propozim kaloi për shkak se mori 73 (shtatëdhjetë e tre) vota për, 1 (një) kundër dhe 23 (njëzet e tri) abstenime. Prandaj, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 09-V-017] zgjodhi deputeten Emilija Redžepi në pozitën e nënkryetares së zgjedhur të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.
- (v) kërkoi nga 108 (njëqind e tetë) deputetët e pranishëm, që të votojnë kandidatin e propozuar nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, i cili propozim nuk kaloi për shkak se mori 10 (dhjetë) vota për, 55 (pesëdhjetë e pesë) kundër dhe 23 (njëzet e tri) abstenime;
- (vi) ftoi edhe një herë përfaqësuesin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, që të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky i fundit propozoi deputetin Slavko Simić, si dhe theksoi se nënkryetari që përfaqëson këtë komunitet mund të propozohet vetëm nga shumica e deputetëve që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kuvend. Ky propozim nuk kaloi për shkak se mori 10 (dhjetë) vota për, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kundër dhe 21 (njëzet e një) abstenime;
- (vii) ftoi edhe një herë përfaqësuesin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, që të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku ky i fundit propozoi deputetin Slavko Simić, si dhe theksoi se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kishte shkelur Rregulloren e Kuvendit kur ka ndarë votimin për nënkryetarin nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë. Ky propozim nuk kaloi për shkak se mori 10 (dhjetë) vota për, 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kundër dhe 21 (njëzet e një) abstenime.
- (viii) ftoi edhe një herë përfaqësuesin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, që të propozojë nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës por që të mos përsërisë kandidatin Slavko Simić duke qenë se bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, i njëjti kandidat mund të propozohet vetëm 3 (tre) herë, si dhe theksoi se nuk lejohet debat në Seancën Konstituive. Megjithatë, ky i fundit mori fjalën dhe theksoi se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit duke mos e vendosur në votim propozimin e tyre kishte shkelur Rregulloren e Kuvendit dhe i njëjti nuk është kompetent për të interpretuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese;

- (ix) ftoi edhe 2 (dy) herë përfaqësuesin e deputetëve të komunitetit Serb, që të propozojë një emër tjetër për nënkryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me paralajmërimin se në rast të mospropozimit të kandidatit, bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, propozimi i kandidatëve bëhet me short. Megjithatë, ky i fundit insistoi në kandidatin e njëjtë dhe të drejtën e subjektit të tij politik për të propozuar nënkryetarin si dhe kërkoi *“një orë konsultë për hir të konstruktivitetit”*;
- (x) ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare te foltorja për një konsultë të shkurtër, dhe pas konstatimit se Lista Serbe refuzoi që të propozojë kandidat tjetër, vazhdoi Seancën Konstituive me hedhjen e shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, në të cilën procedurë Lista Serbe refuzoi të marrë pjesë. Sipas procedurës së shortit, votimi dështoi dy herë për kandidaten Verica Čeranić me rezultatin asnjë votë për, 50 (pesëdhjetë) vota kundër dhe 20 (njëzet) abstenime, ndërsa një herë për kandidatin Stefan Kovačević, me rezultati asnjë votë për, 48 (dyzet e tetë) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime. Deputetja Ljiljana Stefanović refuzoi që të jetë kandidatë, ashtu si edhe deputetja Verica Čeranić, e cila për herë të tretë refuzoi të kandidohej. Rrjedhimisht, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit eliminoi nga gara këto dy candidate. Ndërsa, kandidati i radhës sipas shortit ishte deputeti Nenad Rašić, për të cilin po ashtu dështoi votimi me rezultatin, nga 95 (nëntëdhjetë e pesë) deputetë të pranishëm, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota për, 1 (një) votë kundër dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) abstenime;
- (xi) ndërpreu Seancën Konstituive deri më 28 gusht 2025, ora 11:00.
33. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-018], [nr. 09-V-019], [nr. 09-V-020], [nr. 09-V-021], [nr. 09-V-022], [nr. 09-V-023], dhe [nr. 09-V-024] nuk zgjodhi deputetët Slavko Simić, Verica Čeranić, Stefan Kovačević dhe Nenad Rašić, nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
34. Më 28 gusht 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit e vazhdoi Seancën Konstituive përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit që përfaqëson komunitetin Serb, me hedhjen e shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. Sipas procedurës së shortit:
- (i) Votimi për deputetin Branislav Nikolić dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
1. Herën e parë, ku të pranishëm ishin 107 (njëqind e shtatë) deputetë, asnjë votë për, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota kundër dhe 25 (njëzet e pesë) abstenime;
 2. Herën e dytë, asnjë votë për, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) abstenime;
 3. Herën e tretë, asnjë votë për, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) abstenime;
- (ii) Votimi për deputetin Zlatan Elek dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
1. Herën e parë, ku të pranishëm ishin 107 (njëqind e shtatë) deputetë, asnjë votë për, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime;
 2. Herën e dytë, ku të pranishëm ishin 98 (nëntëdhjetë e tetë) deputetë, asnjë votë për, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime;
 3. Herën e tretë, asnjë votë për, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime;
- (iii) Votimi për deputetin Stefan Kovačević dështoi 2 (dy) herë me rezultatin si vijim:

1. Herën e parë, asnjë votë për, 53 (pesëdhjetë e tri) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime;
 2. Herën e dytë, asnjë votë për, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota kundër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) abstenime;
 - (iv) Votimi për deputetin Srđan Popović dështoi 3 (tri) herë me rezultatin si vijim:
 1. Herën e parë, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) abstenime;
 2. Herën e dytë, asnjë votë për, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota kundër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) abstenime;
 3. Herën e tretë, asnjë votë për, 52 (pesëdhjetë e dy) vota kundër dhe 15 (pesëmbëdhjetë) abstenime;
 - (v) Votimi për deputetin Igor Simić dështoi me rezultatin asnjë votë për, 55 (pesëdhjetë e pesë) vota kundër dhe 18 (tetëmbëdhjetë) abstenime;
 - (vi) Votimi për deputetin Nenad Rašić dështoi me rezultatin 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, 1 (një) kundër dhe 20 (njëzet) abstenime.
35. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, pasi që konstatoi se deputetët Branislav Nikolić, Zlatan Elek, Stefan Kovačević dhe Srđan Popović eliminohen nga gara si rezultat i dështimit të votimit për 3 (tri) herë, e ndërpreu Seancën Konstituive, me propozimin që të vazhdojnë konsultimet mes grupeve parlamentare për votimin e deputetit Nenad Rašić.
36. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-025], [nr. 09-V-026], [nr. 09-V-027], [nr. 09-V-028], [nr. 09-V-029], [nr. 09-V-030], [nr. 09-V-031], [nr. 09-V-032], [nr. 09-V-033], [nr. 09-V-034], [nr. 09-V-035], [nr. 09-V-036], dhe [nr. 09-V-037] nuk zgjodhi deputetët Branislav Nikolić, Zlatan Elek, Stefan Kovačević, Srđan Popović, Igor Simić dhe Nenad Rašić, nënkryetar të Kuvendit nga komuniteti Serb.
37. Më 30 gusht 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit e vazhdoi Seancën Konstituive përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit që përfaqëson komunitetin Serb, me hedhjen e shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. Sipas procedurës së shortit, ku refuzuan të marrin pjesë deputetët e Listës Serbe:
- (i) Votimi për deputeten Miljana Nikolić dështoi 3 (tri) herë me rezultatin e njëjtë si në vijim, asnjë votë për, 52 (pesëdhjetë e dy) vota kundër dhe 24 (njëzet e katër) abstenime;
 - (ii) Votimi për deputetin Nenad Rašić dështoi me rezultatin 56 (pesëdhjetë e gjashtë) vota për, asnjë kundër dhe 21 (njëzet e një) abstenime;
 - (iii) Votimi për deputetin Igor Simić dështoi 2 (dy) herë me rezultatin e njëjtë si vijim, asnjë votë për, 54 (pesëdhjetë e katër) vota kundër dhe 22 (njëzet e dy) abstenime.
38. Në të njëjtën ditë, Kuvendi përmes vendimeve [nr. 09-V-038], [nr. 09-V-039], [nr. 09-V-040], [nr. 09-V-041], [nr. 09-V-042], dhe [nr. 09-V-043] nuk zgjodhi deputetët Miljana Nikolić, Nenad Rašić dhe Igor Simić nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
39. Nga transkripti i mbledhjes së Seancës Konstituive së mbajtur më 30 gusht 2025, rezulton se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, pasi që konstatoi se deputetët Miljana Nikolić, Nenad Rašić dhe Igor Simić eliminohen nga gara si rezultat i dështimit të votimit për 3 (tri) herë, dhe konsideroi se, pasi janë shterur të gjitha tentativat për të marrë votat e nevojshme dhe theksoi se: *“[...] pasi tetë prej tyre nuk kanë marrë votat e nevojshme për nënkryetar të Kuvendit në të gjitha tentativat, ndërsa dy prej tyre kanë refuzuar të jenë kandidat për*

nënkryetar.”, ishte ezauruar pika e IV-të e rendit të ditës së Seancës Konstituive përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë. I njëjti përmbylli punimet e Seancës Konstituive me arsyetimin se: “*Në emër të funksionalizimit të Kuvendi dhe materializimit të rezultatit zgjedhor të 9 shkurtit 2025, konsideroj që moszgjedhja e njërit nga pesë nënkryetarët apo njërit nga gjashtë anëtarët e Kryesisë, nuk mund të bëhet pengesë që bllokoi konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës*”, si dhe theksoi se: “*Pas përmbjlljes së seancës konstituive, konsideroj që Kuvendi i Republikës sonë duhet të vazhdojë punën siç parashihet me Kushtetutë, ndërkaq se si të veprohet tutje në lidhje me punën tonë si Kuvend konsideroj që do t’i konsultoj anëtarët e zgjedhur tanimë të Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen që do të mbahet në Zyrën C-301 të hënën, në orën 13:00.*”

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

40. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e “*Procesverbaleve të seancave të Kuvendit të Kosovës*” dhe vendimeve të nxjerra në seancat e 26 dhe 28 gushtit 2025. Më saktësisht, të njëjtit kontestojnë: (i) “*procedurën e zhvilluar për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës nga radha e komuniteteve jo-shumicë të datës 26.08.2025*”; (ii) “*vendimin për zgjedhjen e nënkryetares Emilija Redžepi nga radha e komunitetit jo-shumicë jo-serb, përkatësisht komuniteteve të tjera në Kosovë që nuk janë shumicë*” dhe (iii) “*vazhdimin e seancës dhe tentimin për të zgjedhur nënkryetarin nga radha komunitetit jo-shumicë të serbëve, si dhe procedurën e tërësishme të zhvilluar për zgjedhjen e nënkryetarit nga radha komuniteteve jo-shumicë në Kosovë si dhe të gjitha vendimet e Kuvendit të miratuara në seancat e datës 26.08.2025 dhe 28.08.2025*”, me pretendimin se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, duke mos i ftuar përfaqësuesit e komunitetit Serb për të propozuar nënkryetarin nga radha e deputetëve të komunitetit Serb, ka shkelur paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës dhe pikën 1 të paragrafit 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit, si dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese KO119/14, KO124/25 dhe KO193/25 dhe KO196/25, si dhe në kundërshtim me sigurinë juridike, duke shkelur në këtë mënyrë edhe nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Kosovës në lidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.
41. Në kontekst të veçimit të procedurës për votimin e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht atyre Serb dhe joserb, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është shkelur paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës si dhe paragrafi 6 i nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, sepse sipas tij, “[...] *zgjedhja e nënkryetarit bëhet në një procedurë të vetme me qëllim të sigurimit të efikasitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave [...]*”, në pajtim me “[...] *parimet e gjithëpërfshirjes dhe barazisë, pa mundësinë e ndarjes selektive që mundëson manipulimin e shumicës.*”
42. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, duke anashkaluar propozimin e përfaqësuesit më të madh të subjektit politik që përfaqëson komunitetin Serb, ka shkelur nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, me arsyetimin se: “[...] *veproi ndryshe në situata të njëjta ose të ngjashme kur ishte fjala për zgjedhjen e tre nënkryetarëve nga radha e komunitetit shqiptar të Kosovës*”, dhe se në këtë kontekst, sipas tij, pa arsye kishte zhvilluar shortin në bazë të paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës si dhe pikën 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.

43. Në këtë drejtim, të njëjtit gjithashtu konsiderojnë se: “[...] fituesi i zgjedhjeve nga radha e komunitetit serb duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të propozuar nënkryetarin për komunitetin serb, ashtu siç fituesi i zgjedhjeve ka të drejtën ekskluzive për të propozuar kryetarin e Kuvendit nga radha e komunitetit shqiptar. Gjithashtu, ne konsiderojmë se nëse propozuesi nga radha e komunitetit shqiptar ka të drejtën për pauza prej 48 orësh dhe për konsultime, edhe komunitetet e tjera duhet të kenë të njëjtën të drejtë”.
44. Tutje, parashtresit e kërkesës po ashtu në kërkesën e tyre theksojnë se: “Është normale që nëse subjekti politik Vetëvendosje ka fituar numrin më të madh të mandateve nga subjektet politike shqiptare dhe ka të drejtën ekskluzive për të propozuar Kryetarin e Kuvendit, gjë që është konstatuar me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, atëherë është e pamundur t’i mohohet e njëjta e drejtë subjektit politik që fitoi numrin më të madh të votave nga radha e komunitetit serb kur bëhet fjalë për vendin e Nënkryetarit nga radha e komunitetit serb, sepse kjo cenon parimet e përfaqësimit proporcional dhe mbrojtjes së pakicave.”
45. Në fund, parashtresit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që:
- “1. Të pranojë kërkesën si të bazuar sepse, në pajtim me nenin 113 paragrafi 5, ajo parashtrëhet nga dhjetë deputetë kundër vendimit të Kuvendit për veçimin e votimit për nënkryetarë nga radha e komuniteteve jo-shumicë.
 2. Të konstatojë se Kryetari i Kuvendit ka shkelur nenin 67 par. 4 të Kushtetutës dhe nenin 12 par. 6 pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe se ai ka vepruar në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese KO119/14, KO124/25 dhe KO193/25 dhe KO196/25.
 3. Të konstatojë se Kryetari i Kuvendit ka shkelur kompetencat e tij dhe se ai, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, së pari i ka ftuar komunitetet e tjera jo-shumicë të bëjnë propozimin, edhe pse në Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit është përcaktuar qartë se propozimi i parë nga radha e komuniteteve jo-shumicë paraqitet nga komuniteti serb.
 4. Të konstatojë se Kryetari i Kuvendit ka shkelur kompetencat e tij dhe se ai, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, ka veçuar votimin për nënkryetarët e Kuvendit nga radha e komuniteteve jo-shumicë, edhe pse, në pajtim me Kushtetutën, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe praktikën e deritanishme të Kuvendit, si dhe dispozitivin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, ai duhet të zhvillohet si një votim i vetëm, përkatësisht i unifikuar për dy nënkryetarë nga radha e komuniteteve jo-shumicë.
 5. Të konstatojë se zgjedhja e Nënkryetarit nga radha e komunitetit jo-serb jo-shumicë është kundërkushtetuese sepse është zhvilluar në kundërshtim me nenin 67 par. 4 të Kushtetutës dhe nenin 12 par. 6 pika 1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, si dhe se ai ka vepruar në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese KO119/14, KO124/25 dhe KO193/25 dhe KO196/25.
 6. Të urdhërojë Kryetarin e Kuvendit të zbatojë kthimin në gjendjen e mëparshme, me të cilin do të anulohen veprimet kundërkushtetuese të Kryetarit të Kuvendit të përshkruara më sipër.
 7. Të urdhërojë që në pajtim me sigurinë juridike të përsëritet procedura e votimit për nënkryetarët nga radha e komuniteteve jo-shumicë në një votim të unifikuar. [...]”

Kërkesa për masë të përkohshme

46. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që: “8. Të caktojë, duke pasur parasysh interesin publik, masën e përkohshme, me të cilën do të ndalojë veprimet e mëtejshme kundërkushtetuese të Kryetarit të Kuvendit, në mënyrë që të mos zgjidhet Qeveria kundërkushtetuese ose të fillojnë të rrjedhin afatet për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, për shkak se mosaktimi i masës së përkohshme do të shkaktojë dëme të pariparueshme dhe potencialisht do të çonte në formimin e institucioneve kundërkushtetuese, duke cenuar kështu rendin juridik dhe demokratik në Kosovë.”

Komentet e Presidentes

47. Më 9 shtator 2025, Presidentja dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
48. Fillimisht, Presidentja thekson se: “[...] bllokimi i konstituimit të Kuvendit për shkak të moszgjedhjes së vetëm një nënkryetari gjatë seancës konstituive, përderisa Kryesia ka kuorum, do ta cenonte në mënyrë serioze jo vetëm funksionalitetin institucional, por edhe vetë themelet dhe vlerat mbi të cilat është ndërtuar Republika e Kosovës. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në vlera dhe parime themelore të tilla si: demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut, sundimi i ligjit dhe ndarja e pushteteve.” Në këtë drejtim, Presidentja argumentoi përkthazi me: “(i) të drejtat e garantuara në Kushtetutë bartin detyrimin e pandashëm për të mosabuzuar me to, dhe (ii) Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet të bllokohet si pasojë e veprimeve të cilësdo parti politike apo komuniteti.”
49. Më tutje, Presidentja citon paragrafin 4 të nenit 57 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës duke vënë në theks se: “Ky nen i Kushtetutës ngërthen në vete dy parime themelore, të cilat janë parakushte për realizimin e të drejtave: së pari, detyrimin për të vepruar në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, dhe së dyti, detyrimin që nëpërmjet ushtrimit të të drejtave vetanake, të mos shkelen apo cenohen të drejtat e të tjerëve.” Për më tepër, Presidentja thekson se: “Në rastin konkret, cenimi nuk është vetëm në raport me deputetet e tjerë të Kuvendit, të cilëve po u pamundësohet ushtrimi i funksionit, por edhe me të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët që nga dhjetori i vitit 2024 nuk e kanë institucionin e tyre përfaqësues, pra Kuvendin, funksional e duke punuar në interes të tyre.”
50. Në vazhdim, Presidentja duke iu referuar nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës potencon se: “[...] bllokimi i konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nën arsyetimin e garantimit të të drejtave të komuniteteve mund të ketë efekt krejtësisht të kundërt meqenëse e pamundëson thuaja në tërësi realizimin dhe mbrojtjen e tyre në praktikë. Pra, edhe vetë koncepti i shoqërisë multientike është i pamundur të realizohet në një shtet jofunksional.”
51. Presidentja duke u mbështetur në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës thekson se neni 17 (Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave) i KEDNJ-së ndalon shprehimisht abuzimin me të drejtat dhe “[...] se asnjë shtet, grup ose person nuk mund të angazhohet në aktivitete, të cilat kanë për synim shkatërrimin e ndonjë të drejtë ose lirie të përcaktuar me Konventë” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Refah Partisi dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98 dhe 41344/98, Aktgjykim i 13 shkurtit 2003, paragrafi 99, [Perincek kundër Zvicrës](#), nr. 27510/08, Aktgjykim i 15 tetorit 2015, paragrafi 113, [Zdanoka kundër Letonisë](#), nr. 58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006,

paragrafi 99). Në këtë drejtim, po ashtu citon Opinionin e Komisionit të Venecias Nr. [CDL-AD \(2005\) 004](#) duke shtuar se Komisioni i Venecias kishte gjetur se “[...] vetoja e një grupi është mekanizëm mbrojtës, por jo mjet politik për bllokim” (shih [CDL-AD \(2005\) 004](#), Mendim mbi Situatën Kushtetuese në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kompetencat e Përfaqësuesit të Lartë, miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e tij të 62-të plenare, më 11-12 mars 2005). Lidhur me rastin konkret, Presidentja shton: “[...] nëse çdo grupacioni që propozon një nënkryetar në procesin e funksionalizimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i garantohet një e drejtë e tillë e vetos ne atë mënyrë që të parandalojë dhe paralizojë konstituimin e Kuvendit, atëherë kjo do të krijonte një precedent të rrezikshëm dhe një gamë të gjerë të mundësive për bllokim nga secili dhe në çdo kohë”.

52. Në vijim, Presidentja konsideron se, meqë Kryetari dhe 4 (katër) nënkryetarët e Kuvendit janë zgjedhur, atëherë Kuvendin e bënë institucion funksional dhe se komunitetit Serb i është dhënë mundësia për propozim të kandidatit/es për nënkryetar/e, të cilët kanë propozuar kandidatë, mirëpo të njëjtit nuk i kanë marrë votat e nevojshme. Në këtë drejtim vë në theks se: “[...] në interes të konstituimit të Kuvendit, konsiderojmë se përderisa është shterur mundësia për zgjedhjen e nënkryetarit/es gjatë seancës konstituive, kjo mundësi duhet t'i jepet përsëri komunitetit serb në cilëndo nga seancat e radhës së Kuvendit, deri ne zgjedhjen e tij/saj, por pa e bllokuar konstituimin e institucionit.”
53. Tutje, Presidentja thekson se ka pasur raste kur ishte konstituuar Kuvendi edhe kur nuk ishin zgjedhur të gjithë nënkryetarët, respektivisht në vitin 2001, 2004 dhe 2008, ku konsideron se pavarësisht faktit se 3 (tri) legjislaturat e përmendura janë konstituuar para miratimit të Kushtetutës, “[...] edhe në atë kohë ka ekzistuar një dispozitë e ngjashme me atë të Kushtetutës, e cila garantonte një pozitë për komunitetin joshumicë serb”.
54. Në fund, Presidentja kërkon nga Gjykata që: “[...] të mos lejojë që cilado parti politike apo komunitet të ketë të drejtën e vetos në procese jetike për shtetin, siç është konstituimi i organit më të lartë përfaqësues të tij. Çdo përcaktim ndryshe, rrezikon që të legjitimojë bllokime procedurale të themelimit të institucioneve kyçe, në nivel të normës kushtetuese, juridikisht të detyrueshme.”

Komentet e LVV!

55. Më 9 shtator 2025, deputetët e LVV!, të përfaqësuar nga deputetja Saranda Bogujevci, dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
56. Fillimisht, deputetët e LVV! konsiderojnë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar argumente, të cilat do të mund të mbështesnin pranueshmërinë e saj, për shkak se (i) mungon akti i kontestuar; dhe (ii) “mungon e legjitimiteti i nënshkrimeve kur numri prej dhjetë (10) deputetesh nuk plotësohet nga deputetët e atij komuniteti”. Përkritazi me mungesën e aktit të kontestuar theksojnë se: “Kushtetuta parasheh në mënyrë eksplicite se objekt i kontrollit kushtetues mund të jenë vetëm aktet e miratuara të Kuvendit, qofshin ato materiale apo procedurale. Në rastin konkret, një akt i tillë nuk ekziston. Parashtruesit e kanë orientuar kërkesën e tyre ndaj një procedure të ndërprerë, e cila nuk është materializuar në një akt të miratuar dhe, rrjedhimisht, nuk ka pësuar asnjë pasojë juridike.”

57. Në këtë drejtim, deputetët e LVV! theksojnë se: *“Parashtruesit përmes paragjykitimit po kontestojnë përpjekjet për miratimin e një akti të Kuvendit. Pamundësia objektive për të marrë vendim nuk mund të shërbejë si objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese bazuar në argumentin e mësipërm sipas juridiksionit të saj i përcaktuar në nenin 113, paragrafi 5, nuk ka të drejtë të bëjë interpretimin e përpjekjeve, tentimeve, vazhdimëve apo edhe të mendimeve, qëndrimeve, apo sjelljes së deputeteve gjatë vijimit të seancës konstituive, por vetëm të akteve formale të votuara në Kuvend.”*
58. Tutje, deputetët e LVV! konsiderojnë se: *“deputetët parashtrues nga Lista Serbe janë vetëm 9 të tillë. Ata kanë marrë nënshkrimin e një deputeti jashtë komunitetit serb, siç është deputeti Adem Hoxha edhe pse në Kuvend ka dhe një deputet tjetër të komunitetit serb. Deputeti Adem Hoxha është deklaruar se përfaqëson komunitetin goran në Kosovë dhe si i tillë është i zgjedhur dhe i njohur nga KQZ. Nuk kuptohet pse një deputet i një komuniteti joshumicë (jo serb), i cili përfaqësohet tashmë nga një nënkryetar tjetër i Kuvendit, duhet të bashkëngjitet në parashtrësën e kontestimit të nënkryetarit që vjen nga radha e komunitetit serb. Nëse ndiqet logjika e parashtruesve as deputeti Adem Hoxha nuk duhet të lejohet të jetë nënshkrim i rregullt dhe i pranueshëm për këtë kërkesë.”*
59. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës së veçimi i votimit për dy nënkryetarët që vijnë nga komunitetet që nuk janë shumicë është në kundërshtim me Kushtetutën, deputetët e LVV! konsiderojnë se parashtruesit e kërkesës kanë lexuar në mënyrë të gabuar paragrafin 4 të nenit 67 duke theksuar se: *“Madje vetë paragrafi 4 i nenit 67 i veçon dy nënkryetarët, ashtu siç edhe janë të veçuara komunitetet përkatëse, kur thotë se “Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb”, kurse “[...] dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë”.* Tutje, deputetët e LVV! theksojnë se: *“Fakti që Kushtetuta përcakton se kriteri për zgjedhjen e dy nënkryetarëve është marrja e shumicës së votave të të gjithë deputetëve, nuk nënkupton se këta dy nënkryetarë duhet detyrimisht të votohen bashkë.”*
60. Gjithashtu, deputetët e LVV! shtojnë se: *“[...] votimi i veçuar jo vetëm se nuk përbën akt në kundërshtim me Kushtetutën, por është akt i domosdoshëm për pasqyrimin real dhe të papenguar apo të pandikuar të vullnetit të deputetëve. Këtë e dëshmoi edhe procesi i votimit në rastin e zgjedhjes së znj. Emilja Rexhepi si nënkryetare nga komunitetet joshumicë, jo serbe, ndërsa asnjëri nga kandidatët që mbajnë vendet e rezervuara nga komuniteti pakicë serb nuk mori votat e mjaftueshme.”*
61. Deputetët e LVV! duke cituar një rast të Gjykatës Kushtetuese Federale të Austrisë theksojnë se: *“[...] ushtrimi i një të drejte kushtetuese bëhet abuziv kur qëllimi i saj nuk është realizimi i funksionit të parashikuar, por paralizimi i funksionimit të institucioneve shtetërore (VfSlg 16.327/2001). Gjykata kushtetuese austriake, më tej në këtë vendim u shpreh se, një e drejtë që është formalisht e njohur nga Kushtetuta humb mbrojtjen e saj kur përdoret jo për realizimin e funksionit që i ka dhënë rendi kushtetues, por për të paralizuar ose bllokuar funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Ky është një derivim i parimit të përgjithshëm të së drejtës publike sipas të cilit e drejta pushon aty ku fillon abuzimi me të (parimi i proporcionalitetit dhe i “abus de droit”).* Gjithashtu, deputetët e LVV! konsiderojnë se një subjekt politik nuk mund të bllokojë konstituimin e Kuvendit dhe duke iu referuar Opinioni të Komisionit të Venecias me nr. [CDL-AD \(2019\)015](#), theksojnë se: *“Komisioni i Venecias ka konstatuar se interpretimi i dispozitave*

kushtetuese nuk mund të çojë në bllokim të pacaktuar të institucioneve, sepse kjo bie ndesh me parimin e funksionalitetit të organeve kushtetuese, si dhe me parimet themelore të demokracisë dhe sundimit të ligjit.” (shih [CDL-AD \(2019\)015](#), Parametrat mbi Marrëdhënien midis Shumicës Parlamentare dhe Opozitës në një Demokraci: Një Listë Kontrollimi, miratuar nga Komisioni i Venedikut në seancën e tij të 119-të plenare, më 21-22 qershor 2019).

62. *Më tutje, deputetët e LVV! theksojnë se: “Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 67, paragrafi 4) përcakton vetëm numrin dhe përbërjen e nënkryetarëve të Kuvendit, por procedure e zgjedhjes është lënë në dorë të Kuvendit përmes Rregullores së Punës.” Në këtë drejtim, deputetët e LVV! duke iu referuar rasteve të Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë (shih, rastet [BVerfGE 44, 308](#): “Fraktionsrechte”; dhe [BVerfGE 123, 267](#) “Lissabon Urteil”) theksojnë se: “Pretendimet e parashtresve të kërkesës do ta paralizojnë Kuvendin dhe do ta shndërronin të drejtën e përfaqësimit në të drejtë vetoje. Nëse supozimisht do të ndiqej logjika e tyre, atëherë Kuvendi do të paralizohet dhe përfaqësimi komunitetit joshumicë do të degjeneronte në instrument obstruksioni.”*
63. *Gjithashtu, deputetët e LVV!, duke iu referuar rasteve të GJEDNJ-së (shih, rastet e GJEDNJ [Yumak dhe Sadak kundër Turqisë](#), nr. 10226/03, Aktgjykim i 8 korrikut 2008; [Mathieu-Mahin dhe Clerfayt kundër Belgjikës](#), nr. 9267/81, Aktgjykim i 2 marsit 1987, paragrafi 47; [Ždanoka kundër Letonisë \[GC\]](#), cituar më lart, paragrafi 98) konsiderojnë se: “[...] refuzimi i Listës Serbe për të propozuar kandidaturë, me qëllim bllokimin e Kuvendit, nuk gjen mbrojtje në standardet evropiane të demokracisë dhe bie ndesh me vetë parimin e demokracisë efektive të mbrojtur nga Konventa dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.” Tutje, deputetët e LVV! konsiderojnë se: “[...] interpretimi i vetëm i pranueshëm i nenit 67 paragrafi 4 është ai që e kupton normën si kumulative dhe barazuese: një nënkryetar nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet e tjera joshumicë, pa renditje, pa prioritet dhe pa hierarki.”*
64. *Përkitazi me veçimin e procedurës së votimit për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, deputetët e LVV! konsiderojnë se: “[...] votimi i ndarë nuk është devijim, por është mjeti më i përshtatshëm, proporcional dhe i domosdoshëm për të garantuar barazinë faktike dhe funksionalitetin institucional të Kuvendit.” Në këtë drejtim, konsiderojnë se në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës KO193/25 dhe KO196/25, “[...] Kryetari i Kuvendit ftoi deri në tre herë radhazi deputetët e komunitetit serb, të cilët mbajnë vendet e rezervuara, që të propozonin kandidat për nënkryetar. Pas dështimit të kandidatit Slavko Simiq për të marrë votat e nevojshme në të tri rastet, grupi i deputetëve parashtres refuzoi ftesën për të paraqitur një kandidat alternativ. Një refuzim i tillë në kuptim të aktgjykimeve KO 193/25 dhe KO196/25, përbën jo ushtrim të së drejtës për të propozuar, por heqje dorë nga ajo e drejtë.”*
65. *Ndërsa, përkitazi me pretendimin e parashtresve të kërkesës se vazhdimi me procedurën e shortit është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës, deputetët e LVV! konsiderojnë se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit ka vepruar në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe aktgjykimeve të Gjykatës, duke theksuar se: “Problemi nuk konsiston në mohimin e së drejtës për të kandiduar, por në refuzimin e deputetëve parashtres për të propozuar kandidatë alternativë dhe në mungesën e mbështetjes së mjaftueshme për ata kandidatë që dolën nga shorti.”*
66. *Tutje, deputetët e LVV! theksojnë se: “Lista Serbe pretendon që Gjykata të marrë për bazë analogjinë e Grupit më të madh parlamentar dhe të drejtën për të propozuar kandidatin*

për Kryetar të Kuvendit vis a vis të drejtës që dhe komuniteti serb në Kuvend duhet të ketë. Problemi qëndron se Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh këtë të drejtë për nënkryetarin nga komuniteti jo shumicë serb. Por Kushtetuta nuk e parasheh as për komunitetin jo shumicë jo serb.”

67. Në fund, deputetët e LVV! kërkojnë nga Gjykata që: “I. Ta hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën KO265/25 që lidhet me: (a) “procedurën e zhvilluar”, “vazhdimin e seancës” dhe/ose “tentimin” për zgjedhjen e nënkryetarit nga komuniteti joshumicë serb, meqë nuk ekziston asnjë akt i miratuar i Kuvendit që mund të jetë objekt kontrolli në kuptim të nenit 113 paragrafi 5 të Kushtetutës; dhe, (b) mungesën e legjitimitetit të nënshkrimeve kur numri prej dhjetë (10) deputetesh nuk plotësohet nga deputetët e atij komuniteti, si keqpërdorim i së drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës; II. Të konstatojë se Kuvendi ka vepruar në pajtim me Kushtetutën dhe aktgjykimin KO193/25 dhe KO196/25, duke: (a) aplikuar kufizimin numerik për nënkryetarët në tri (3) propozime për të njëjtin kandidat si mekanizëm deblokues - sikurse në rastin e Kryetarit; dhe, (b) përdorur shortin si mjet neutral kur mungon propozimi, pa cenuar të drejtat e deputetëve; III. Të konstatojë se, pas shterimit të të gjitha fazave procedurale (tri propozime për të njëjtin kandidat dhe procedura e shortit) pa arritur shumicën e kërkuar për kandidatin nga komuniteti serb, konstituimi i Kuvendit është i vlefshëm dhe Kuvendi vazhdon punimet për përmbushjen e detyrimeve të tjera kushtetuese.”

Komentet e “Grupit Multietnik”

68. Më 9 shtator 2025, deputetët e “Grupit Multietnik” në Kuvend, të përfaqësuar nga deputeti Elbert Krasniqi, dorëzuan në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
69. Përkitazi me pretendimet e parashtresve të kërkesës se zgjedhja e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë duhet të bëhet vetëm në pako, pra duke zgjedhur dy nënkryetarët nga komunitetet që nuk janë shumicë njëkohësisht, deputetët e “Grupit Multietnik” theksojnë se: “Jo vetëm se një procedurë e tillë nuk parashihet as me Kushtetutë e as me Rregullore, por edhe vet fakti që përfaqësuesit e Listës Serbe kanë marrë pjesë në proces dhe kanë propozuar kandidatë për votim dëshmon se procedura ishte e hapur dhe e pranuar prej tyre, respektivisht e rregullt dhe kushtetuese.”
70. Deputetët e “Grupit Multietnik” po ashtu në komentet e tyre nënvizojnë preferencën e tyre që të mos votohen përfaqësuesit e tyre në pako me përfaqësuesit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb dhe theksojnë se kjo ishte arsyeja se pse propozuan që votimi për nënkryetarët e nga radhët e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë të bëhet ndarazi. Në këtë kontekst ata shprehën se: “Procedura e ndjekur, gëzon legjitimitetin e plotë demokratik, të shprehur përmes votimit të të zgjedhurve të popullit. Gjatë seancës nuk pati asnjë kundërshtim konkret nga ndonjë grup apo deputet për këtë procedurë.”
71. Përkitazi me pretendimet e parashtresve të kërkesës se paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës u jep atyre të atyre të drejtën ekskluzive për të propozuar dhe për të zgjedhur nënkryetarin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, deputetët e “Grupit Multietnik” konsiderojnë se nuk ka detyrim të Kuvendit për miratim të kandidatit të tyre, por që “I vetmi detyrim i deputetëve është që të marrin pjesë në votim, duke votuar për, kundër apo i abstenuar për çdo kandidat të propozuar.”

72. Tutje, deputetët e “Grupit Multietnik” theksojnë se: *“Dispozitat kushtetuese përcaktojnë se dy nënkryetarët që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, ashtu si edhe tre nënkryetarë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Ky formulim përjashton çdo formë ekskluziviteti partiak, duke e bërë të qartë se garancia është përfaqësimi i komunitetit, jo imponimi i një kandidati nga një subjekt i vetëm politik.”*
73. Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se Kuvendi nuk mund të funksionojë pa zgjedhjen e një nënkryetari nga radhët e tyre, deputetët e “Grupit Multietnik” pretendojnë se: *“Kushtetuta nuk parashikon të drejtë vetoje për asnjë grup parlamentar. Vendosja e një kushti të tillë do të krijonte një precedent të rrezikshëm, ku një subjekt politik me një pakicë votash mund të bllokonte funksionimin e institucioneve.”* Për më tepër, të njëjtit theksojnë se *“Përfaqësimi i komunitetit serb është i garantuar me vendet e rezervuara, por kjo nuk nënkupton se çdo kandidat i propozuar nga Lista Serbe do të zgjidhet automatikisht.”*, pasi që çdo zgjedhje kërkon mbështetjen e shumicës parlamentare, duke përfshirë grupin e tyre, si dhe sipas tyre, *“[...] ulëset e rezervuara garantojnë përfaqësim, jo dominim”*. Në këtë kontekst, ata përmendin rastet kur Kuvendi në praktikë ka funksionuar edhe kur disa pozita kanë mbetur të paplotësuara përkohësisht. Po ashtu, të njëjtit i referohen Aktgjykimit [U-5/98] të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë Hercegoviznës, i cili shpalli antikushtetues çdo përkufizim që i jepte një entiteti karakter të njëanshëm etnik, për të cilin pretendojnë se është: *“[...] precedent është i zbatueshëm edhe në rastin e Kosovës, ku vendet e garantuara për komunitetin serb nuk mund të interpretohen si monopol i një partie të vetme.”*
74. Deputetët e “Grupit Multietnik” gjithashtu konsiderojnë se: *“[...] çdo e drejtë shtesë që potencialisht do i jepej Listës Serbe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës do ishte privilegj i një grupi ndaj komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë. Kjo nuk mund të jetë barazi para ligjit sipas vlerave e parimeve të Kushtetutës, por vetëm mbivendosje e një grupi me rezultat edhe pasivizimin e institucionit më të lartë në vend [...]”*.
75. Në fund, deputetët e “Grupit Multietnik”, i kërkojnë Gjykatës që: *“[...] të mos marr[in] për bazë ankesën e Listës Serbe sepse kjo do të prishte balancat e respektimit të të drejtave të të gjithë komuniteteve jo shumicë të përfaqësuara në institucionet e vendit.”*

Komentet e Kryetarit të zgjedhur të Kuvendit, z. Dimal Basha

76. Më 9 shtator 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, z. Dimal Basha dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me kërkesën.
77. Fillimisht, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se më 26 gusht 2025, ishte zgjedhur Kryetar i Kuvendit me shumicë votash, dhe në atë cilësi, kishte vazhduar drejtimin e Seancës Konstituive në lidhje me pikën e IV-të të rendit të ditës, gjegjësisht, me zgjedhjen e nënkryetarëve. I njëjti nënvizon se (i) votimi i kandidatëve për nënkryetarë nga subjektet parlamentare shqiptare ishte bërë në pako, duke qenë se kishte konsensus për këtë, kandidatë këta që kishin marrë votat e mjaftueshme për t’u zgjedhur, ndërsa (ii) votimi për nënkryetarë i kandidatëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, ishte bërë ndarazi për shkak të kërkesës së përfaqësuesit të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, gjegjësisht, deputetit Elbert Krasniqi, të cilët refuzuan që të marrin pjesë në votimin në pako me kandidatët e komunitetit Serb. Si rezultat, dhe meqenëse sipas tij, *“[...] në mungesë të konsensusit dhe me synimin për të ushtruar funksionin tim në interesin më*

të mirë të funksionalizimit të Kuvendit të Republikës, dhe në pajtim me Rregulloren dhe Kushtetutën e vendit [...]” ka proceduar me votimin e ndarë për 2 (dy) nënkryetarët që janë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë.

78. *Më tutje, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se: “[...] si Kryetar Kuvendi e kam njoftuar përfaqësuesin e komunitetit serb se, në frymën e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO193/25 dhe KO196/25 të datës 18 gusht 2025, kandidati Slavko Simiq nuk mund të jete propozim i radhës sepse është ezauruar mundësia e tij për t’u zgjedhur, meqenëse 3 herë radhazi nuk ka manë votat e mjaftueshme për t’u zgjedhur nënkryetar dhe rrjedhimisht duhet të propozojnë një kandidat tjetër.” Gjithashtu, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit sqaron se pasi përfaqësuesi nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb refuzoi propozimin e ndonjë kandidati tjetër, vazhdoi me procesin e shortit sipas paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Punës së Kuvendit.*
79. *Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideron se: “Me rastin e moszgjedhjes së asnjërit nga kandidatet për nënkryetar nga komuniteti joshumicë serb, u ezaurua e gjithë procedura dhe në këtë kontekst u ezaurua edhe pika e 4-të e rendit të ditës së seancës konstituive. [...] Për pasojë, seanca përfundoi me Kuvend të konstituuar sepse: 1. Kuvendi tanimë ka ezuatuar rendin e ditës në tërësi, 2. Kuvendi tanimë e posedon kurorumin e mjaftueshëm në Kryesi për të qenë plotësisht funksional, dhe 3. Konstituimi ka ndodhur në linjë me Rregulloren e Punës së Kuvendit, e cila gjithmonë është interpretuar në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe në funksion të përmbushjes së qëllimit kushtetues të konstituimit të Kuvendit, siç edhe na obligon vet Aktgjykimi i Gjykatës i datës 18 gusht.”*
80. *Përkitazi me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për zgjedhjen e nënkryetares nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, para propozimit të kandidatit për nënkryetar të komunitetit Serb, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se: “[...] askund në Kushtetutën e Kosovës dhe në asnjë akt tjetër juridik të shtetit tone nuk përcaktohet hierarkia, supremacia apo përparësia e një komuniteti tjetër mbi një komunitet tjetër, andaj procedura e zgjedhjes fillimisht të nënkryetarit nga komunitetet joshumicë joserbe nuk përbën asnjë lloj shkelje, e aq më pak shkelje kushtetuese; [...]” Gjithashtu, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se komuniteti Serb nuk ka pasur kundërshtim lidhur me votimin e ndarë, ka propozuar kandidat për nënkryetar dhe ka marrë pjesë në votim.*
81. *Përkitazi me procesin e shortit, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se kjo procedurë është e përcaktuar me paragrafin 4 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë drejtim, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konsideron se: “[...] tek votimi me short nuk përcaktohet se kush është propozuesi, por paragrafi në fjalë vetëm flet në numrin e të gjithë kandidatëve të komunitetit serb që bëhen pjesë e shortit për votim - pa ndonjë të drejtë eksplicite të ndonjë shumicë, subjekti apo grupi parlamentar - dhe çfarëdo përjashtimi i ndonjë emri nga radhët e komunitetit joshumicë serb do të ishte veprim diskriminues dhe në kundërshtim me nenin 67 paragrafin 4 të Kushtetutës dhe me Rregulloren e Kuvendit;”*
82. *Tutje, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se: “Kuvendi ka përmbushur fazën e tij të konstituimit me faktin se është ezauruar në tërësi pika 4 e rendit të ditës sipas vetë procedurës së Aktgjykimit KO193/25 dhe KO196/25. Procesi ka përfunduar me zgjedhjen e 5 anëtareve të Kryesisë nga gjithsej 6. Ky fakt e bën Kryesinë e Kuvendit funksionale dhe të gatshme të vazhdojë punën e saj pa asnjë pengesë. Kjo do të thotë se Kuvendi ka kuorum të mjaftueshëm për të proceduar me punën e tij, përfshirë miratimin e ligjeve, diskutimet dhe angazhimet e tjera të rëndësishme për zhvillimin e institucioneve të Kosovës.”*

83. Përkitazi, me pretendimin e parashtruesve të kërkesës për refuzimin e kërkesës për pauzë 48 (dyzet e tetë) orëshe, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se nuk ka relevancë juridike, për shkak se ky afat përmendet në aspekt të kufirit maksimal të lejuar për ndërprerje të seancës konstituive.
84. Tutje, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit thekson se: “[...] mosarritja e konsensusit për një kandidat të caktuar nuk prodhon pasoja juridike mbi legjitimitetin apo vlefshmërinë e përbërjes së Kryesisë, për atë kohë sa Kuvendi ka zgjedhur numrin e mjaftueshëm të anëtarëve që i përmbushin kërkesat për kuorum, dhe në këtë mënyrë garanton funksionalitetin e strukturës drejtuese të tij.”
85. Në fund, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkon nga Gjykata që: “[...] të nxjerrë Aktgjykim përmes të cilit të lejojë procedimin me vijimin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse siç e nënvizon edhe vetë Gjykata në Aktgjykimin e aj KO124/25, paragrafi 143 “nuk ka interes më të mirë të Republikës së Kosovës, që organi më i lartë përfaqësues të jetë i konstituuar dhe të fillojë punë sa më parë”.

Dispozitat relevante kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 1

[Përkufizimi i Shtetit]

- “1. Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.
2. Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.
3. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.”

Neni 2

[Sovraniteti]

- “1. Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
3. Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.”

Neni 3

[Barazia para Ligjit]

- “1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

Neni 4 **[Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]**

- “1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.*
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
5. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
6. Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
7. Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.”

Neni 7 **[Vlerat]**

- “1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.*
2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Neni 24 **[Barazia para Ligjit]**

- “1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.”

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. [...]”

Neni 58
[Përgjegjësitë e Shtetit]

“[...]”

7. Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë.”

Neni 63
[Parimet e Përgjithshme]

“Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.”

Neni 64
[Struktura e Kuvendit]

“1. Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.

2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon: (1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.”

Neni 65
[Kompetencat e Kuvendit]

“Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;

- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;
- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;
- (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.”

Neni 66 **[Zgjedhja dhe Mandati]**

- “1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.
4. Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për aq sa zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
5. Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.”

Neni 67 **[Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve]**

- “1. Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
2. Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
3. Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
4. Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të

Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.

5. Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

6. Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.”

Neni 74 **[Ushtrimi i Funksionit]**

“Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.”

Neni 116 **[Efekti Juridik i Vendimeve]**

“1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme.

3. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.

4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.”

RREGULLORE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

KREU IV **KONSTITUIMI I KUVENDIT**

Neni 7 **(Seanca konstituive)**

“1. Seancën konstituive të Kuvendit e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve.

2. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk e thërret seancën konstituive, Kuvendi mbledhet vetë në ditën e 30 (tridhjetë).”

Neni 8 **(Përgatitja e seancës konstituive)**

“1. Përgatitjet për seancën konstituive të legjislaturës së Kuvendit janë përgjegjësi e Kryetarit të legjislaturës së mëparshme.

2. Kryetari i legjislaturës së mëparshme, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit, e thërret mbledhjen e përbashkët me kryetarët e subjekteve politike, që kanë fituar vende në Kuvend, për të përgatitur propozimin e

rendit të ditës dhe për caktimin e vendeve të deputetëve në sallën e seancave plenare. Në rast se mbledhja nuk thirret brenda afatit pesë (5) ditorë, Kuvendi mbledhet vetë, në ditën e caktuar nga Presidenti.

3. Paragrafi 2 i këtij neni, nuk zbatohet në rast se Kuvendi mbledhet sipas nenit 7 paragrafi 2 të kësaj rregulloreje.

4. Rendi i ditës së mbledhjes konstituive të legjislaturës përmban:

4.1. Formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve;

4.2. Betimin e deputetëve;

4.3. Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe

4.4. Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit.

5. Raporti i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve votohet nga Kuvendi.

6. Përcaktimi i vendeve të deputetëve në sallë bëhet sipas fuqisë të subjekteve politike. Nëse dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, renditja e tyre bëhet duke marrë për bazë numrin më të madh të votave që kanë fituar në zgjedhjet për Kuvend.”

Neni 9 (Kryesimi i seancës konstituive)

“[...]

3. Në seancën konstituive nuk zhvillohet debat.

[...].”

Neni 11 (Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit)

“1. Kryetari i Kuvendit zgjidhet në seancën konstituive, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga subjekti politik më i madh në Kuvend, të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit.

3. Kryesuesi i seancës konstituive konstaton rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, shpall zgjedhjen e Kryetarit dhe e fton të zërë vendin e tij.”

Neni 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit)

“1. Nënkyetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Kryetari i Kuvendit kërkon nga tri subjektet politike më të mëdha parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Kandidati për nënkryetar i subjektit më të madh parlamentar duhet të jetë i gjinisë tjetër, nga ai i Kryetarit.

3. Në rast se dy ose më shumë subjekte politike kanë numër të njëjtë të deputetëve, drejta e propozimit të nënkryetarit i takon subjektit që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet për Kuvend.

4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

5. Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Ndërprerjet gjatë seancës konstituive nuk mund të jenë më të gjata se 48 orë.
6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:
- 6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe
- 6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.
7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit.”

Neni 13 (Mandati i Kuvendit)

- “1. Mandati i Kuvendit, vazhdimi i tij dhe shpërndarja e Kuvendit, janë përcaktuar me nenet 66 dhe 82 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Pas shpërndarjes së Kuvendit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Presidenti e dorëzon dekretin e shpërndarjes në Kuvend.
3. Kuvendi e pezullon punën një ditë para fillimit të fushatës për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

86. Në lidhje me vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton se: “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”
87. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar kërkesën e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.”
88. Përveç kritereve të lartcekura kushtetuese, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit, që saktëson parashtrimin e kërkesës në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton si në vijim:

Nenin 42 (Saktësimi i kërkesës)

- “1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 [5] të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:
- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.”

89. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 (Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Rregulli 72

(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)

“(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatit) të Ligjit.

(2) [...]

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit ose vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të ndonjë akti ose ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.”

90. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesa është parashtruar nga 10 (dhjetë) deputetë të Kuvendit, që është minimumi i kërkuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht konsideron se është plotësuar kriteri për palën e autorizuar. Sa i përket kriterit të afatit, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kontestojnë aktet e nxjerra në kuadër të Seancës Konstituive më 26 dhe 28 gusht 2025, ndërsa kërkesën e kanë parashtruar më 30 gusht 2025, respektivisht, brenda afatit 8 (tetë) ditë, të përcaktuar me Kushtetutë dhe Ligj.
91. Gjykata rikujton se parashtruesit theksojnë që mbledhjet dhe aktet e nxjerra në kuadër të Seancës Konstituive, të zhvilluara më 26 dhe 28 gusht 2025 janë në kundërshtim me dispozitivin e Aktgjykimeve të Gjykatës në rastin KO124/25 dhe në rastet KO193/25 dhe KO196/25 dhe, në mënyrë specifike kontestojnë: (i) procedurën për zgjedhjen e nënkryetares së Kuvendit nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, respektivisht, Vendimin [nr. 09-V-017] për zgjedhjen e deputetes Emilija Redžepi, nënkryetare e Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë; si dhe (ii) procedurën për zgjedhjen e nënkryetarit/es të Kuvendit nga komuniteti Serb, gjegjësisht, vendimet për moszgjedhjen e nënkryetarit/es nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
92. Për më tepër, Gjykata bazuar në Aktgjykimin e saj në rastin KO124/25 dhe në kuptim të kërkesave të parashtruara bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës ka vlerësuar se kërkesat e parashtruara përmes të cilave janë kontestuar aktet dhe veprimet e ndërmarra nga deputetët e zgjedhur gjatë zhvillimit të Seancës Konstituive dallojnë nga kërkesat e parashtruara përmes të cilave kontestohen aktet e nxjerra nga organet e Kuvendit apo nga vetë Kuvendi, vendimmarrja e të cilave buronte nga një Kuvend i konstituuar dhe

funksional në kuptimin e autorizimeve të tij ligjvënëse, vendimmarrëse dhe mbikëqyrëse, të përcaktuara me Kushtetutë. Megjithatë me rastin e konstituimit të Kuvendit, Gjykata ka ritheksuar që Seanca Konstituive është një akt kushtetues, e cila konsiderohet si e realizuar vetëm pas përfundimit të (i) verifikimit të mandateve të deputetëve, (ii) dhënies së betimit të deputetëve, dhe (iii) zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se vetë çështja e Seancës Konstituive të Kuvendit përbën çështje kushtetuese, e cila duhet t'i nënshtrohet vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese (shih, rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafët 83, 84 dhe 86).

93. Andaj, duke qenë se nga parashtruesit e kërkesës kontestohen vendimet e Kuvendit përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarëve, të cilat janë nxjerrë në kuadër të zhvillimit të Seancës Konstituive të Kuvendit, respektivisht, më 26 dhe 28 gusht 2025, Gjykata vlerëson se të njëjtat i nënshtrohen vlerësimit dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese.
94. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është e pranueshme për shqyrtim dhe në vijim, do të vazhdojë me vlerësimin e saj në merita.

Meritat e kërkesës

I. Hyrje

95. Gjykata rikujton se Seanca Konstituive e Kuvendit kishte filluar më 15 prill 2025, me rendin e ditës që ishte përcaktuar më 8 prill 2025 nga Kryetari i Legjislaturës së mëparshme (Legjislatura e VIII-të) së bashku me kryetarët e subjekteve politike, që kanë fituar vende në Kuvend, si në vijim: (i) formimi i Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të Deputetëve; (ii) dhënia e betimit të deputetëve; (iii) zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit; dhe (iv) zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit. Pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj në rastet KO193/25 dhe KO196/25, Seanca Konstituive, e cila ishte ndërprerë më 26 korrik 2025, si rezultat i caktimit të masës së përkohshme nga Gjykata, vazhdoi më 20, 22 dhe 24 gusht 2025 përkitazi me pikën e III-të të rendit të ditës, gjegjësisht zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, e cila dështoi për 6 (gjashtë) herë. Më 26 gusht 2025 u zgjodh Kryetari i Kuvendit, me ç'rast përfundoi pika e III-të e rendit të ditës të Seancës Konstituive. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit vazhdoi me punimet e Seancës Konstituive përkitazi me pikën e IV-të dhe të fundit të rendit të ditës, respektivisht, zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Votimi për 3 (tre) nënkryetarët nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare u bë në pako, pasi kishte konsensus ndërmjet tyre, ndërsa votimi për nënkryetarët nga komunitetet që nuk janë shumicë, pas propozimit të përfaqësuesit të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë për veçimin e procedurës së votimit për nënkryetarët nga këto komunitete, u bë ndarazi, me ç'rast u zgjodh nënkryetarja nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, ndërsa, votimi 3 (tri) herë radhazi dështoi për të propozuarin e komunitetit Serb. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi nga komuniteti Serb që të propozojë një kandidat tjetër duke qenë se votimi për të propozuarin e parë kishte dështuar 3 (tre) herë. Përfaqësuesi i komunitetit Serb refuzoi propozimin e kandidatëve tjerë dhe pretendoi shkeljen e Rregullores së Kuvendit, me ç'rast Kryetari i zgjedhur i Kuvendit vazhdoi me votimin e kandidatëve tjerë sipas procedurës së hedhjes së shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. Votimi dështoi për të gjithë kandidatët sipas procedurës së shortit dhe për pasojë seanca u ndërpre. Më pas, Seanca Konstituive vazhdoi më 28 dhe 30 gusht 2025, ku votimi, sipas procedurës së shortit për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, dështoi nga 3 (tre) herë për secilin nga deputetët. Për rrjedhojë, asnjë nga kandidatët nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar i Kuvendit nga radhët e komunitetit

Serb. Më 30 gusht 2025, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit përmbylli punimet e Seancës Konstituive të Kuvendit.

96. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në thelb kontestojnë (a) procedurën e zgjedhjes së nënkryetares nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë dhe (b) procedurën e moszgjedhjes së nënkryetarit/es nga komuniteti Serb, dhe në këtë kontekst, pretendojnë se:
- (i) Veçimi i procedurës për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë bie në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe paragrafin 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve) të Rregullores së Kuvendit, sepse sipas tyre, *“[...] zgjedhja e nënkryetarit bëhet në një procedurë të vetme me qëllim të sigurimit të efikasitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave [...]”,* në pajtim me *“[...] parimet e gjithëpërfshirjes dhe barazisë, pa mundësinë e ndarjes selektive që mundëson manipulimin e shumicë”*. Njëkohësisht, të njëjtit po ashtu pretendojnë se ky veprim shkel edhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, me arsyetimin se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit: *“[...] veproi ndryshe në situata të njëjta ose të ngjashme kur ishte fjala për zgjedhjen e tre nënkryetarëve nga radha e komunitetit shqiptar të Kosovës”;* dhe
 - (ii) Zbatimi i procedurës së shortit bie në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës si dhe pikën 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, pasi që, sipas tyre, *“[...] fituesi i zgjedhjeve nga radha e komunitetit serb duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të propozuar nënkryetarin për komunitetin serb, ashtu siç fituesi i zgjedhjeve ka të drejtën ekskluzive për të propozuar kryetarin e Kuvendit nga radha e komunitetit shqiptar [...]”*.
97. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës kundërargumentohen nga Presidentja, përfaqësuesja e Grupit Parlamentar të LVV!-së, përfaqësuesit e “Grupit Multietnik” dhe Kryetarit të zgjedhur të Kuvendit, të cilët në thelb, argumentojnë se: (i) votimi i veçuar nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, për shkak se nuk është i përcaktuar detyrimi për votim në pako; (ii) kufizimi i propozimit në 3 (tre) herë për kandidatin e njëjtë është zbatuar si mekanizëm deblokues *“sikurse në rastin e Kryetarit”;* (iii) procedura e shortit është zhvilluar në bazë të paragrafit 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit; (iv) *“Kuvendi ka përmbushur fazën e tij të konstituimit me faktin se është ezauruar në tërësi pika 4 e rendit të ditës”;* dhe (v) konstituimi i Kuvendit nuk mund të bllokohet për shkak të moszgjedhjes së një nënkryetari, përderisa Kryesia e Kuvendit ka kuorum.
98. Duke marrë për bazë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, të cilat ndërliken me pikën e IV-të dhe të fundit të rendit të ditës së Seancës Konstitutive, respektivisht, procedurën e zgjedhjes së nënkryetarit/ëve të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, si dhe argumentet dhe kundërargumentet e palëve të interesuara, Gjykata konsideron se çështje kushtetuese dhe objekt i vlerësimit të kësaj kërkeje përbën çështja nëse janë zbatuar Aktgjykimet e fundit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me konstituimin e Kuvendit, respektivisht, nëse: (i) ka përfunduar konstituimi i Kuvendit; dhe (ii) është respektuar procedura kushtetuese për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë.

99. Thënë këtë, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, do t'i rikujtojë (i) parimet e përgjithshme në lidhje me konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, të përcaktuara në Kushtetutë, praktikën gjyqësore të saj dhe Rregulloren e Kuvendit, përfshirë atyre që ndërlidhen me zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, si dhe më pas (iii) të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

I. Parimet e përgjithshme për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit

100. Gjykata fillimisht rikujton paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, përmes të cilit përcaktohet se Republika e Kosovës si “[...] shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.”
101. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës, i cili përcakton se Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur, ku në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Më saktësisht nënparagrafët 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, përcaktojnë se:

[...]

2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

(1) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

(2) partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.”

102. Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës përcakton se “Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë”, ndërsa, paragrafi 6 i po këtij neni përcakton se “Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit”. Për më tepër, paragrafët 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës përcaktojnë se: (i) 3 (tre) nënkryetarët të propozuar nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare, zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe (ii) 2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.

103. Bazuar në leximin e përbashkët të paragrafit 2 të nenit 64 dhe paragrafëve 1, 4 dhe 6 të nenit 67 të Kushtetutës dhe në kontekst të vlerave dhe parimeve mbi të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, të përcaktuara në nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, rezulton se përfaqësimi i komuniteteve që nuk janë shumicë, në Kryesinë e Kuvendit realizohet përmes zgjedhjes së 2 (dy) nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht, në radhën si në vijim: (i) komunitetit Serb; dhe (ii) komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë. Ky përfaqësim nuk është diskrecional, por detyrim kushtetues, i garantuar me dispozitat e lartcekura kushtetuese. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se paragrafi 7 i nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit] të Kushtetutës përcakton se: *“Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuar me këtë Kushtetutë”*.
104. Gjykata sërish thekson që hapi i parë në formimin e institucioneve kushtetuese pas zgjedhjeve, sikurse është përcaktuar në Kushtetutë, përkatësisht pas shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve, është konstituimi i Kuvendit. Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin KO124/25 ka përcaktuar që *“zhvillimi dhe përfundimi i Seancës Konstituive duhet të udhëhiqet në pajtim me përcaktimet kushtetuese për konstituimin e Kuvendit, Kreun IV (Konstituimi i Kuvendit) të Rregullores së Kuvendit dhe praktikat e deritanishme parlamentare për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.”* (shih, paragrafin 187 të Aktgjykimit në rastin KO124/25). Në këtë drejtim dhe marrë parasysh paragrafin 1 dhe 6 të nenit 67 të Kushtetutës, Seanca e Konstituive e Kuvendit, konsiderohet e realizuar vetëm pas zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij. Konstituimi i Kuvendit dhe themelimi i organeve tjera kushtetuese që burojnë nga Kuvendi i shërbejnë ruajtjes së rendit kushtetues duke garantuar ndërveprim të të gjitha pushteteve në shërbim të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës (shih, Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO124/25, cituar më lart, paragrafi 93 dhe KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart, paragrafi 97).
105. Siç është theksuar në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO119/14 dhe aktgjykimet e fundit të Gjykatës përkitazi me konstituimin e Legjislaturës së IX-të të Kuvendit, respektivisht rastet KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, Gjykata ka sqaruar kriteret e konstituimit të Kuvendit dhe detyrimet e deputetëve si në vijim:
- (i) Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës duhet të përmbushet me sukses brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës;
 - (ii) Zgjedhja përmes votimit të hapur i kandidatit/es për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, votim i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë; dhe
 - (iii) Detyrimi i deputetëve që të jenë prezent dhe të votojnë gjatë procedurës së zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
106. Gjykata vë në dukje se sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 67 të Kushtetutës, deputetët fillimisht kanë për detyrim që të zgjedhin Kryetarin e Kuvendit dhe më pas 5 (pesë) nënkryetarët e tij.

107. Gjykata rithekson përmbajtjen e paragrafit 3 të nenit 67 të Kushtetutës, i cili rregullon çështjen e propozimit dhe votimit të propozimit të nënkryetarëve të Kuvendit, duke përcaktuar se *“3 (tre) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”*.
108. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, përkitazi me procedurën e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit, Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin [KO84/18](#), ka sqaruar që sipas paragrafit 3 të nenit 67 të Kushtetutës, për zgjedhjen e 3 (tre) anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, duhet të plotësohen dy kushte, dhe atë, që kandidatët (a) të propozohen nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare dhe (b) të marrin votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit (shih, rastin [KO84/18](#), parashtrues *Albin Kurti dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 3 dhjetorit 2018, paragrafët 91-96).
109. Sa i përket kushtit të parë, Gjykata vëren se Kushtetuta, në paragrafin 3 të nenit 67, në mënyrë të qartë përcakton se e drejta për të propozuar 3 (tre) kandidatë për pozita të nënkryetarëve u takon ekskluzivisht 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare. Gjykata vlerëson se e drejta e 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare për të propozuar kandidatët për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit është thelbësore për ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë në konstituimin e Kuvendit, të qeverisur nga sundimi i ligjit. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rastit [KO119/14](#), ku kishte konstatuar se *“grupi më i madh parlamentar, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kane më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64 (1) të Kushtetutës, se çdo tjetër parti, koalicion, initiative qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tille në zgjedhje.”* (shih, Aktgjykimin në rastin [KO119/14](#), parashtrues *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 21 gushtit 2014, paragrafi 116).
110. Sa i përket kushtit të dytë, Gjykata në praktikën e saj gjyqësore, ka sqaruar se *“me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit”* nënkuptohet se duhet të arrihet minimumi prej 61 (gjashtëdhjetë e një) vota, në një Kuvend prej 120 (njëqind e njëzet) deputetësh, dhe se sipas Gjykatës, shmangia nga ky standard kushtetues, në çfarëdo rrethane, cenon legjitimitetin kushtetues të procesit të konstituimit të Kuvendit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastet [KO193/25](#) dhe [KO196/25](#), cituar më lart, paragrafi 137).
111. Për dallim nga gjuha e paragrafit 3 të nenit 67 që mundëson liri më të gjerë të propozimit, në paragrafin 4 të nenit 67, të Kushtetutës shprehimisht përcaktohet se *“2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, dhe ata zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve”*. Me tutje, në të njëjtin paragraf, Kushtetuta shprehimisht përcakton se *“njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.”*
112. Në këtë rast, përkitazi me zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të tjerë të Kryesisë së Kuvendit, kushti i parë është që (i) i zgjedhuri për nënkryetar/e të jetë kandidati/ja nga radhët e

deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb apo komuniteteve tjera që nuk janë shumicë; ndërsa kushti i dytë (ii) është minimumi prej 61 (gjashtëdhjetë e një) votave për këtë propozim.

113. Gjykata vëren se përderisa kandidatët për nënkryetar/e sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 67 të Kushtetutës mund t'i takojnë edhe grupeve tjera parlamentare me kushtin që propozimi bëhet nga tri (3) grupet më të mëdha parlamentare, në anën tjetër kandidati për nënkryetar nga komunitetet që nuk janë shumicë sipas paragrafit 4 të po këtij neni, domosdoshmërisht duhet t'i takojë komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht, (i) komunitetit Serb dhe (ii) komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, pasi që paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës është i qartë në këtë drejtim.
114. Ndërsa sa i përket procedurës për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, Gjykata vëren se kjo procedurë është shtjelluar tutje në paragrafët 4, 6 dhe 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, të cilët përcaktojnë se:

“[...]

4. Kryetari i Kuvendit kërkon nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb që të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, si dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, të propozojnë një (1) kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

[...]

6. Propozimet nga paragrafi 4 i këtij neni bëhen me shkrim, sipas procedurës si vijon:

6.1. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit serb propozohet nga shumica e deputetëve të komunitetit serb, dhe

6.2. Kandidati për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë propozohet nga shumica e deputetëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë.

7. Në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas paragrafit 6 të këtij neni, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse. Kjo procedurë administrohet nga Kryetari i Kuvendit”.

115. Siç rezulton nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës se nënkryetarët e Kuvendit nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë (i) zgjedhën me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit; dhe propozimi bëhet (ii) me shkrim (iii) nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb apo të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë.
116. Për më tepër, Rregullorja e Kuvendit në paragrafin 7 të nenit 12 të saj dhe pika IV e dispozitivit të Aktgjykimit në rastet KO193/25 dhe KO196/25, përcaktojnë 2 (dy) mekanizma deblokues: (i) procedurën e shortit vetëm në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas procedurës së lartcekur nga ana e komuniteteve që nuk janë shumicë, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse, dhe e administruar nga Kryetari i Kuvendit; dhe (ii) votimi për kandidatin/en e njëjtë mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë.

II. Aplikimi i parimeve në rrethanat e rastit konkret

117. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton se pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të saj në rastet KO193/25 dhe KO196/25, Seanca Konstituive e Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, dhe e ndërprerë më 26 korrik 2025, si rezultat i caktimit të masës

së përkohshme nga Gjykata, vazhdoi më 20, 22 dhe 24 gusht 2025 përkitazi me pikën e III-të të rendit të ditës, gjegjësisht zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, e cila dështoi për 6 (gjashtë) herë. Më 26 gusht 2025, deputeti Dimal Basha u zgjodh Kryetar i Kuvendit, me ç'rast u realizua pika e III-të e rendit të ditës të Seancës Konstituive. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit vazhdoi me punimet e Seancës Konstituive përkitazi me pikën e IV-të dhe të fundit të rendit të ditës, respektivisht, zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit. Votimi për 3 (tre) nënkryetarët nga 3 (tre) grupet më të mëdha parlamentare u bë në pako, pasi kishte konsensus ndërmjet tyre për votimin në pako me ç'rast u zgjodhën deputetët Albulena Haxhiu, Vlora Çitaku dhe Kujtim Shala. Në vijim, si rezultat i propozimit të përfaqësuesit të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, gjegjësisht, deputetit Elbert Krasniqi, për veçimin e procedurës së votimit për nënkryetarët nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, votimi u bë ndarazi, me ç'rast nënkryetare nga radhët e komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë, u zgjodh deputetja Emilija Redžepi ndërsa, votimi 3 (tri) herë radhazi dështoi për të propozuarin e komunitetit Serb, gjegjësisht, deputetin Slavko Simić. Në të njëjtën ditë, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit kërkoi nga ky komunitet që të propozojë një kandidat tjetër duke qenë se votimi për të propozuarin e parë kishte dështuar 3 (tre) herë dhe në frymën e Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, i njëjti kandidat maksimalisht mund të propozohet tre herë. Përfaqësuesi i komunitetit Serb refuzoi propozimin e kandidatëve tjerë dhe pretendoi shkeljen e Rregullores së Kuvendit, me ç'rast Kryetari i zgjedhur i Kuvendit vazhdoi me votimin e kandidatëve tjerë sipas hedhjes së shortit bazuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit. Votimi dështoi për deputetët Verica Čeranić, Stefan Kovačević dhe Nenad Rašić dhe për pasojë seanca u ndërpre. Seanca Konstituive vazhdoi më 28 dhe 30 gusht 2025, ku votimi sipas procedurës së shortit për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb dështoi nga 3 (tre) herë për secilin nga deputetët në vijim: Branislav Nikolić, Zlatan Elek, Stefan Kovačević, Srđan Popović, Igor Simić, Miljana Nikolić dhe Nenad Rašić, ndërsa deputetët Verica Čeranić dhe Ljiljana Stefanović refuzuan kandidaturën. Për rrjedhojë, asnjë nga kandidatët nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar i Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb. Më 30 gusht, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit i "përmbylli" punimet e Seancës Konstituive të Kuvendit.

118. Në vijim, Gjykata do të adresojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës në dritën e parimeve të përgjithshme duke i aplikuar ato në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Përkitazi me procedurën e zgjedhjes së nënkryetares nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë*

119. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në thelb kontestojnë procedurën e zgjedhjes së nënkryetarëve nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë, me pretendimin se veçimi i procedurës për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë bie në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve] të Kushtetutës dhe paragrafin 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve) të Rregullores së Kuvendit, sepse sipas tyre, zgjedhja e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë duhet të bëhet në një procedurë të vetme, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të drejtave të komuniteteve që nuk janë shumicë, në pajtim me parimet e gjithëpërfshirjes dhe barazisë, pa mundësinë e ndarjes selektive. Njëkohësisht, të njëjtit po ashtu pretendojnë se ky veprim shkel edhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, me arsyetimin se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit: "[...] veproji ndryshe në situata të njëjta ose të ngjashme kur ishte fjala për zgjedhjen e tre nënkryetarëve nga radha e komunitetit shqiptar të Kosovës".

120. Në këtë drejtim, përkitazi me zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit nga paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës, respektivisht 2 (dy) nënkryetarëve që propozohen nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, Gjykata fillimisht vëren se votimi i tyre për këtë pozitë ishte bërë ndarazi si pasojë e propozimit të përfaqësuesit të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë, i cili, pas propozimit të kandidatës së tyre, kërkoi në mënyrë shprehimore nga Kryetari i zgjedhur i Kuvendit që të veçohet procedura për zgjedhjen e nënkryetarëve respektivë.
121. Gjykata rikujton se nga dispozitat kushtetuese, të Rregullores së Kuvendit dhe praktika gjyqësore e Gjykatës nuk rezultojnë ndonjë obligim i deputetëve për votimin në pako të nënkryetarëve të Kuvendit, qofshin ata që propozohen nga 3 (tre) grupet më të mëdha parlamentare apo komunitetet që nuk janë shumicë. Në këtë kontekst, duke qenë se votimi në pako nuk është shprehimisht i përcaktuar në Kushtetutë, i njëjti mund të realizohet nëse ka dakordim në mes të grupeve parlamentare apo deputetëve. Gjykata vëren se bazuar në praktikën parlamentare për zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë që nga viti 2011, nënkryetarët nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, janë votuar dhe zgjedhur në pako. Kësisoj, Gjykata vlerëson që një procedurë e tillë e votimit mbetet në vullnetin e deputetëve dhe grupeve parlamentare me kushtin që të realizohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit.
122. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, bazuar në Transkriptin e vazhimit të Seancës Konstitutive më 26 gusht 2025, në kontekst të procedurës së zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga paragrafi 3 i nenit 67 të Kushtetutës, Gjykata vëren se Kryetari i zgjedhur i Kuvendit konstatoi se: *“Kemi konsensus të përfaqësuesit të tri subjekteve më të mëdha të grupeve parlamentare që të vazhdojmë me votimin në pako.”* Në vijim, i njëjti pas propozimit veç e veç të kandidatëve për nënkryetarë nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare, procedoi me votimin në pako, me ç’rast kandidatët e propozuar morën shumicën e nevojshme për zgjedhjen në këtë pozitë, respektivisht, 101 (njëqind e një) vota për, asnjë kundër dhe 9 (nëntë) abstenime.
123. Në vijim, bazuar në transkriptin e lartcekur, në kontekst të procedurës së zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit nga paragrafi 4 i nenit 67 të Kushtetutës, respektivisht, 2 (dy) nënkryetarëve nga komunitetet që nuk janë shumicë, Gjykata vëren se votimi i tyre për këtë pozitë ishte bërë ndarazi si pasojë e propozimit të përfaqësuesit të deputetëve nga radhët e komuniteteve tjera që nuk janë shumicë për të vazhduar në pako. Ndonëse, siç u theksua më lart, ekziston një radhë në zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit nga komunitetet që nuk janë shumicë, me ç’rast parimisht fillohet me votimin e kandidatit për nënkryetar nga komuniteti Serb e më pas të kandidatit nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, Gjykata vlerëson se deputetët e zgjedhur nuk ishin dakorduar për votimin në pako të nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë.
124. Për më tepër, përkitazi me zgjedhjen e nënkryetares Emilija Redžepi, Gjykata vëren se bazuar në përcaktimet kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit, (i) kandidatja ishte propozuar me shkrim, përmes shkresës [09/050/DO-031] të 26 gushtit 2025; (ii) nga shumica e deputetëve të komuniteteve tjera që nuk janë shumicë; (iii) kishte kuorum për vendimmarrje; (iv) votimi ishte i hapur; si dhe (v) kandidatja kishte marrë shumicën e nevojshme për zgjedhjen në këtë pozitë, respektivisht, 73 (shtatëdhjetë e tre) vota për, 1 (një) kundër dhe 23 (njëzet e tri) abstenime.

125. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se procedura për zgjedhjen e nënkryetares së Kuvendit nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë nuk është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës.

(ii) *Përkitazi me procedurën e (mos)zgjedhjes së nënkryetarit/es nga komuniteti Serb*

126. Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesës në kontekst të kontestimit të procedurës për moszgjedhjen e nënkryetarit/es nga komuniteti Serb pretendojnë se zbatimi i procedurës së shortit bie në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës si dhe pikës 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, pasi që, sipas tyre, “[...] fituesi i zgjedhjeve nga radha e komunitetit serb duhet të ketë të drejtën ekskluzive për të propozuar nënkryetarin për komunitetin serb, ashtu siç fituesi i zgjedhjeve ka të drejtën ekskluzive për të propozuar kryetarin e Kuvendit nga radha e komunitetit shqiptar [...]”.

127. Gjykata rikujton se bazuar në paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës dhe nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të nenit 12 (Zgjedhja e nënkryetarëve) të Rregullores e Kuvendit rezulton se nënkryetari i Kuvendit nga komuniteti Serb (i) zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, respektivisht 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për; dhe propozimi (ii) bëhet me shkrim (iii) nga shumica e deputetëve nga radhët e komunitetit Serb.

128. Nga si më sipër, Gjykata nënvizon se propozimi për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, në rastin konkret, të komunitetit Serb, duhet që të bëhet nga shumica apo numri më i madh i deputetëve nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.

129. Në këtë kontekst, Gjykata përsërit se mekanizimi deblokues i përcaktuar në pikën IV të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, i cili obligoi deputetët e zgjedhur të Kuvendit që të votojnë vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë për Kryetar/e të Kuvendit, vlen edhe në rastin e zgjedhjes së nënkryetarëve të Kuvendit.

130. Tutje, Gjykata gjithashtu rikujton se në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit përcaktohet një mekanizëm tjetër deblokues që në rast të mospropozimit të kandidatëve sipas procedurës së lartcekur nga ana e komuniteteve që nuk janë shumicë, propozimi i kandidatëve bëhet me short, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse, dhe procedura administrohet nga Kryetari i Kuvendi.

131. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se më 26 gusht 2025, (i) kandidati për nënkryetar ishte propozuar me shkrim përmes shkresës [09/049/Do-030] të 26 gushtit 2025; si dhe (ii) i njëjti ishte propozuar nga shumica e deputetëve të komunitetit Serb. Megjithatë, i njëjti 3 (tri) herë radhazi nuk mori shumicën e nevojshme të përcaktuar me Kushtetutë për zgjedhjen e tij si nënkryetar.

132. Në këtë drejtim, Gjykata bazuar në Transkriptin e vazhdimit të Seancës Konstituive më 26 gusht 2025, rikujton se pavarësisht kërkesës së Kryetarit të zgjedhur të Kuvendit që komuniteti Serb të propozojë kandidatin tjetër, kjo nuk ndodhi, me ç’rast i njëjti konstatoi se me refuzimin e këtij grupi që të propozojë kandidatin tjetër, duhet proceduar me propozimin e kandidatëve përmes shortit, në prani të deputetëve të komuniteteve përkatëse, të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit.

133. Gjykata vlerëson se para se të procedohej me procedurën e propozimit të kandidatëve për nënkryetar të komunitetit Serb, shumicës së komunitetit Serb i ishte dhënë e drejta që të propozojë kandidatin e tyre në përputhje me nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, por si rezultat i mospropozimit të kandidatit tjetër në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit procedoi me mekanizimin deblokues të përcaktuar në dispozitat e lartcekura të Rregullores së Kuvendit.
134. Gjykata vëren se procedura e propozimit të kandidatëve për nënkryetar/e të Kuvendit nga komuniteti Serb, përmes shortit, u vazhdua më 28 dhe 30 gusht 2025. Megjithatë, nga votimet e realizuara, në të cilat kishte kuorum, asnjë nga kandidatët e propozuar nga 3 (tre) herë, nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur në këtë pozitë, ndërsa dy kandidate refuzuan kandidaturën.
135. Në rrethanat e rastit konkret, dy mekanizmat deblokues, respektivisht, (i) votimi 3 (tri) herë për të njëjtin kandidat dhe (ii) procedura e shortit, i kanë dhënë mundësinë Kuvendit që të votojë njërin nga kandidatët e propozuar për nënkryetar të Kuvendit nga komuniteti Serb. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se deputetët e zgjedhur të Kuvendit kanë dështuar që të zgjedhin njërin nga nënkryetarët e Kuvendit, apo anëtarin e pestë të Kryesisë së Kuvendit pasi që asnjëri nga kandidatët nuk mori 61 (gjashtëdhjetë e një) vota për t'u zgjedhur në këtë pozitë.

(iii) *Përkitazi me konstituimin e Kuvendit*

136. Gjykata rikujton se Presidentja, Kryetari i zgjedhur i Kuvendit, grupi parlamentar i LVV! dhe “Grupi Multietnik” në komentet e tyre të dorëzuara në Gjykatë në lidhje me kërkesën e tanishme, pretenduan se përkundër mos zgjedhjes së nënkryetarit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, Kuvendi është konstituuar.
137. Lidhur me këtë, Gjykata edhe një herë i referohet paragrafit 1 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, i cili përcakton se “*Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë*”, si dhe paragrafit 6 të po këtij neni, i cili përcakton se: “*Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit*”. Tutje, Gjykata rikujton se 2 (dy) nga nënkryetarët e Kuvendit, njëkohësisht, anëtarë të Kryesisë së tij, i përkasin komuniteteve që nuk janë shumicë, e që shprehimisht përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës, si në vijim: “*Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.*”
138. Thënë këtë, bazuar në leximin e përbashkët të paragrafit 2 të nenit 64 dhe paragrafëve 1, 4 dhe 6 të nenit 67 të Kushtetutës, rezulton se përfaqësimi i komuniteteve që nuk janë shumicë në strukturën e Kryesisë së Kuvendit, është garanci kushtetuese, në mënyrë që edhe komunitetet që nuk janë shumicë, respektivisht, komuniteti Serb dhe komunitetet tjera që nuk janë shumicë, të përfshihen në funksionimin e plotë të Kryesisë së Kuvendit duke iu mundësuar atyre që të marrin pjesë në vendimmarrjen e Kryesisë së Kuvendit, në mënyrën e përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit.

139. Gjykata rikujton se hapi i parë pas shpalljes zyrtare të rezultatit të zgjedhjeve, është konstituimi i Kuvendit, nëpërmjet Seancës Konstituive, e cila është akt kushtetues formal, përmes të cilit në mënyrë taksative janë përcaktuar pikat e rendit të ditës, për konstituimin e Kuvendit. Konkretisht, e cila seancë sipas paragrafit 4 të nenit 8 (Përgatitja e seancës konstituive) të Rregullores së Kuvendit, përmban rendin e ditës në vijim: (i) Formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve; (ii) Betimin e deputetëve; (iii) Zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit dhe (iv) Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit.
140. Gjykata do t'u referohet edhe Aktgjykimeve të saj në rastet KO124/25, si dhe KO193/25 dhe KO196/25, përmes të cilave ka theksuar se Seanca e konstituimit të Kuvendit, konsiderohet e realizuar vetëm pas zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të tij. Konstituimi i Kuvendit dhe themelimi i organeve tjera kushtetuese që burojnë nga Kuvendi i shërbejnë ruajtjes së rendit kushtetues duke garantuar ndërveprim të të gjitha pushteteve në shërbim të demokracisë dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës (shih, Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO124/25, cituar më lart, paragrafi 93 dhe KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart, paragrafi 97).
141. Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore rithekson se një Seancë Konstituive që mbahet, por nuk e zgjedh Kryetarin/en dhe nënkryetarët e Kuvendit është seancë e papërfunduar, meqenëse nuk përmbush kërkesën e paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton Seancën Konstituive pas zgjedhjeve të Legjislaturës së V-të të Kuvendit, e cila ishte objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë para Gjykatës në rastin KO119/14, me ç'rast Gjykata kishte vendosur që *"Seanca konstituive e Kuvendit, që ka filluar me 17 korrik 2014, nuk është realizuar plotësisht, konkretisht nuk janë zgjedhur Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit."* (shih pikën II.c. të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO119/14, cituar më lart). Në këtë kuptim, Gjykata po ashtu thekson se mos arritja e shumicës së kërkuar për zgjedhjen e kandidatit për nënkryetar/e të Kuvendit, përbën në anën tjetër, dështim të deputetëve për të përmbyllur me sukses Seancën Konstituive, edhe në kuptim të detyrimit kushtetues të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 66 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 129).
142. Gjykata rikujton se më 19 prill 2025 në kuadër të vazhdimit të Seancës Konstituive të filluar me 15 prill 2025, ku të pranishëm ishin 120 (njëqind e njëzet) deputetë, (i) u votua në mënyrë unanime për formimin dhe raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Kuorumit dhe të Mandateve të deputetëve, si dhe (ii) të gjithë deputetët dhanë betimin e tyre, duke realizuar kështu pikën e I-rë dhe të II-të të rendit të ditës së Seancës Konstituive (shih, Aktgjykimin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 29).
143. Pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, Seanca Konstituive e Kuvendit, e filluar më 15 prill 2025, dhe e ndërprerë më 26 korrik 2025, si rezultat i caktimit të masës së përkohshme nga Gjykata në rastet KO193/25 dhe KO196/25, vazhdoi më 20, 22, 24, 26 gusht 2025 përkritazi me pikën e III-të të rendit të ditës, gjegjësisht zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit, e cila pikë u realizua më 26 gusht 2025, pas 6 (gjashtë) tentativave.
144. Gjykata vë në spikamë se Seanca Konstituive u vazhdua në të njëjtën ditë më 26 gusht 2025 me pikën e IV-të të rendit të ditës për zgjedhjen e nënkryetarëve, me ç'rast 3 (tre)

nënkryetarë nga 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare dhe nënkryetarja nga komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, u zgjedhën.

145. Gjykata nënvizon se pavarësisht shfrytëzimit të dy mekanizmave deblokues, (i) votimit 3 (tre) herë për të njëjtin kandidat dhe (ii) procedurës së shortit, nënkryetari nga komuniteti Serb nuk u zgjodh sepse asnjë nga kandidatët nuk mori votat e nevojshme për t'u zgjedhur nënkryetar i Kuvendit nga radhët e komunitetit Serb, në vazhdimin e Seancës Konstituive më 28 dhe 30 gusht 2025.
146. Ashtu siç u tha më lart dhe konfirmuar në Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO124/25, si dhe KO193/25 dhe KO196/25, Gjykata rithekson se Kushtetuta përcakton se Seanca Konstituive përmbyllet vetëm pas zgjedhjes së Kryetarit dhe të gjithë nënkryetarëve, çështje kjo tashmë e vendosur nga Gjykata që nga viti 2014, në pikën II.c. të dispozitivit të Aktgjykimit të saj në rastin KO119/14 dhe e konfirmuar përmes paragrafit 5 të nenit 12 të Rregullores së Kuvendit, të miratuar në vitin 2022, e cila përcakton shprehimisht se: *"Seanca konstituive përfundon me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit"*.
147. Prandaj, duke qenë se në rrethanat e rastit konkret, deputetët e zgjedhur të Kuvendit, përkundër alternativave të ofruara, nuk kanë realizuar detyrimin e tyre për zgjedhjen e nënkryetarit/es së Kuvendit nga komuniteti Serb, i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, Gjykata konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk është konstituuar ashtu siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 66 dhe paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës, dhe Aktgjykimet e Gjykatës në rastet KO119/14, KO124/25 si dhe KO193/25 dhe KO196/25, si dhe Rregulloren e Kuvendit.
148. Pavarësisht konkluzionit të lartcekur, Gjykata sqaron se në rastet kur e drejta kushtetuese në procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit gjatë konstituimit të Kuvendit nuk ushtrohet nga deputetët apo grupet parlamentare, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, qofshin ato nga komuniteti shumicë apo nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë, të cilat mund të manifestohen në pengimin e këtij procesi, apo në rastet kur, përkundër vullnetit të shumicës së deputetëve për të zgjedhur anëtarin e Kryesisë, Kuvendi i pamundësohet zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë së saj, Kuvendi përjashtimisht, do të mund të vazhdojë funksionimin edhe pa njërin nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, me kushtin që Kryesia e Kuvendit të ketë kuorum në vendimmarrjen e saj në përputhje me paragrafin 3 të nenit 20 (Mbledhja e Kryesisë) të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton se: *"Vendimi i Kryesisë merret me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje."* Megjithatë, Gjykata thekson se ky nuk është rasti në rrethanat konkrete sepse dështimi për konstituimin e Kuvendit në rastin e tanishëm i atribuohet mosvotimit të shumicës së deputetëve të zgjedhur të Kuvendit, për kandidatët e propozuar, qoftë (i) të propozuar drejtpërdrejt nga radhët e deputetëve të komuniteteve që nuk janë shumicë, respektivisht komunitetit Serb; ose (ii) përmes procedurës së shortit.
149. Gjykata rikujton se përmes aktgjykimeve të saj ka urdhëruar deputetët e zgjedhur të Kuvendit:
 - (i) të përmbushin me sukses Seancën Konstituive të Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve, përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë zgjedhjen e Kryetarit/es sipas paragrafit 2 të nenit 67 dhe nënkryetarëve sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës;

- (ii) të zgjedhin përmes votimit të hapur kandidati/en për Kryetar/e të Kuvendit të Republikës së Kosovës, votim i cili mund të realizohet vetëm deri në 3 (tre) herë për kandidatin/en e njëjtë;
 - (iii) të jenë të pranishëm dhe të votojnë gjatë procedurës së zgjedhjes së Kryetarit/es dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
150. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rithekson se pas hyrjes në fuqi të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KO193/25 dhe KO196/25 më 18 gusht 2025, afati i fundit për përfundimin e Seancës Konstituive ishte 17 shtatori 2025.
151. Gjykata rikujton se më 4 shtator 2025, vendosi, *ex officio* dhe sipas kërkesës së parashtruesve të kërkesës së tanishme KO265/25, masën e përkohshme përmes të cilës ndaloi çdo veprim i deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe çdo procedurë për formimin e Qeverisë, me ç'rast u pezullua afati i lartcekur, me efekt prej 5 shtatorit 2025 dhe në kohëzgjatje deri më 30 shtator 2025.
152. Për pasojë, Gjykata konsideron se afati prej 30 (tridhjetë) ditëve për konstituimin e Kuvendit ende nuk është konsumuar duke qenë se kanë mbetur edhe 12 (dymbëdhjetë) ditë për realizimin e Seancës Konstituive, respektivisht, përfundimin e pikës së IV-të të rendit të ditës përmes zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb.
153. Gjykata ka parasysh se votimi për 8 (tetë) kandidatët nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb ka dështuar nga 3 (tri) herë, ndërsa 2 (dy) kandidate kanë refuzuar kandidaturën. Megjithatë, Gjykata konsideron se kriteri për votimin 3 (tri) herë për të njëjtin kandidat, i përcaktuar si mekanizëm deblokues në pikën IV të Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, në vetvete nuk mund të bëhet pengesë për konstituimin e Kuvendit, nëse (i) afati 30 (tridhjetë) ditor për konstituimin e Kuvendit nuk ka përfunduar dhe me kusht (ii) që të ketë vullnet të deputetëve të zgjedhur të Kuvendit për ta konstituuar Kuvendin.
154. Në këto rrethana, deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të konstitudojnë Kuvendin brenda afatit të mbetur prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve, gjithnjë duke respektuar procedurën e përcaktuar me Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit. Gjykata rikujton obligimin e deputetëve që të marrin pjesë në punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në votim, përkritazi me propozimet e paraqitura në bazë të Kushtetutës dhe rregullave tjera të ndërlidhura.
155. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se deputetët e zgjedhur të Kuvendit duhet të jenë të pranishëm dhe votojnë për, kundër apo të abstenojnë për zgjedhjen e nënkryetarit të komunitetit Serb, në frymën e detyrimit për bashkëpunim konstruktiv në mirëbesim, i cili buron nga vetë neni 67 i Kushtetutës, dhe i cili ndërlidhet ngushtë edhe me (i) detyrimin e përcaktuar në nenin 74 të Kushtetutës, sipas të cilit deputetët e Kuvendit ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit, dhe (ii) duke pasur parasysh obligimin e përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 58 të Kushtetutës që Republika e Kosovës, siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuara me këtë Kushtetutë. Njëkohësisht, një detyrim i tillë vlen edhe për grupet tjera parlamentare të cilët në frymën e bashkëpunimit dhe konsultimeve konstruktive propozojnë kandidatët për nënkryetarë të Kuvendit, të cilët bazuar në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 67 të Kushtetutës, po ashtu zgjedhen me shumicën e

votave të të gjithë deputetëve (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 130),

156. Ashtu siç u theksua më lart, përfaqësimi i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kuvend përfshirë edhe në Kryesinë e Kuvendit është detyrim kushtetues. Nëse Kuvendi nuk arrin të zgjedhë nënkryetarin nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, Kryesia e saj do të ishte e paplotë dhe jokushtetuese. Në këtë kontekst, zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit nga komuniteti Serb si anëtar i domosdoshëm i Kryesisë së Kuvendit, është parakusht për konstituimin e Kuvendit.
157. Ashtu siç është theksuar edhe përmes praktikës së saj gjyqësore, në kuptim të funksionimit efektiv të institucioneve shtetërore, Gjykata në vazhdimësi ka ritheksuar që në shërbim të ruajtjes së rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohet në parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, pluralizmit dhe ndarjes së pushtetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është burim i autoritetit të çdo pushteti qeverisës dhe ajo përcakton kufijtë e ushtrimit të këtij autoriteti (shih, Aktgjykimet e Gjykatës, në rastin KO124/25, paragrafi 103 dhe në rastet KO193/25 dhe KO196/25, paragrafi 130).
158. Në kuptim të përfundimit të Seancës Konstituive, Gjykata rithekson rëndësinë e vazhdimit të kësaj seance dhe përfundimit të saj me konstituimin e Kuvendit në përputhje me parimet dhe vlerat kushtetuese të përcaktuara si në Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata fton deputetët e zgjedhur të Kuvendit që të ndjekin frymën e mirëbesimit dhe bashkëpunimit konstruktiv në mënyrë që të përmbushin me sukses detyrimin e tyre kushtetues për përfundimin e Seancës Konstituive, duke zgjedhur anëtarin e pestë të Kryesisë së Kuvendit, respektivisht, nënkryetarin e Kuvendit nga komuniteti Serb (shih, *mutatis mutandis* Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart, paragrafi 135).
159. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson që struktura e normave kushtetuese, dhe posaçërisht ajo që ndërlidhet me themelimin e institucioneve shtetërore që burojnë nga vota e popullit, duhet të interpretohet në atë mënyrë që të jetësojë dhe jo bllokojë themelimin dhe ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre. Kësisoj, të gjitha veprimet që ndërmerren nga deputetët e zgjedhur të Kuvendit në rastin e përmbushjes së pikës IV të rendit të ditës së Seancës Konstituive, duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO124/25, cituar më lart, paragrafi 188).
160. Gjykata përsërit që përderisa funksionimi demokratik i institucioneve shtetërore është përgjegjësi parësore e secilit person i cili është i mveshur me autorizime publike, të gjitha veprimet që ndërmerren nga personat e mveshur me fuqi ose autorizim publik duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën dhe frymën e saj dhe të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe bashkërendimin e punëve me interes publik për shtetin, duke mundësuar që ai të zhvillohet dhe të jetësojë vlerat dhe parimet mbi të cilat është ndërtuar. Sipas Gjykatës çdo pengesë ose mungesë bashkëpunimi në përmbushjen e detyrimeve dhe autorizimeve kushtetuese, është në kundërshtim me frymën e Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës KO72/20, parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, i 30 prillit 2020, paragrafët 476-478 dhe KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart, paragrafi 107).

161. Gjkata, nënvizon, që bazuar në paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Në ndërlidhje me këtë, rregulli 60 (Zbatimi i vendimeve) i Rregullores së Punës të Gjykatës gjithashtu përcakton që: (i) të gjitha organet kushtetuese, përfshirë gjykatat e autoritetet tjera, janë të obliguara të respektojnë dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre (shih, po ashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, cituar më lart, paragrafi 106).
162. Në fund, Gjkata konsideron se në përputhje me rolin e saj kushtetues si autoritet përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, e vënë në lëvizje përmes kërkesave të parashtruara në Gjykatë nga palët e autorizuar, në mënyrë shteruese ka interpretuar dispozitat kushtetuese sa i përket procesit të konstituimit të Kuvendit, të zhvilluar përmes Seancës Konstituive të tij të filluar më 15 prill 2025. Rrjedhimisht, Gjkata rithekson se Seanca Konstituive e Kuvendit, në kuptim të paragrafit 1 të nenit 66 të Kushtetutës është një akt kushtetues që duhet të realizohet përmes përmbushjes të të gjitha elementeve thelbësore të konstituimit, përfshirë në këtë rast edhe zgjedhjen e nënkryetarit/es nga radhët e komunitetit Serb, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 4 të nenit 67 të Kushtetutës dhe çdo interpretim ndryshe do të relativizonte rendin kushtetues të Republikës së Kosovës dhe do të nënkuptonte tolerim të bllokimit institucional, në kundërshtim me natyrën funksionale të një demokracie të udhëhequr nga parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullat 46 (4) dhe 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 30 shtator 2025, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, që Seanca Konstituive e Kuvendit, e filluar me 15 prill 2025 nuk ka përfunduar si rezultat i moszgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, dhe Kuvendi nuk është konstituuar në pajtim me përcaktimet e paragrafit 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] dhe paragrafët 1 dhe 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- III. TË URDHËROJË, që Seanca Konstituive e Kuvendit të përfundojë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 66 [Zgjedhja dhe Mandati] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas Aktgjykimit të Gjykatës në rastet KO193/25 dhe KO196/25, përkatësisht brenda afatit të mbetur prej 12 (dymbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi;
- IV. TË URDHËROJË, të gjithë deputetët e zgjedhur të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që gjatë procedurës së zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e deputetëve të komunitetit Serb, të ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;
- V. TË VAZHDOJË, masën e përkohshme, e cila ka hyrë në fuqi nga data 5 shtator 2025, deri në hyrjen në fuqi të këtij Aktgjykimi;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e publikimit nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe njoftimit të palëve, përveç pikës V të dispozitivit, e cila hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Enver Peci

Nexhmi Rexhepi